

GRUPET ETNIKE TË ZADRIMËS



Në ditët e sotme ka shpërthyer një luftë krejt e pakuptimtë rreth figurës së poetit tonë kombëtar At Gjergj Fishta, ku një grup njerëzish po theksojnë me të madhe se ai ishte mirditor me origjinë nga Domgjoni, apo Paci i Domgjonit të Mirditës. Të tjerët thonë se ai ishte zadrivor i lindur dhe i rritur në Fishtë të Zadrime, gjë që është e saktë për nga vendlindja, por ka gjasa të jetë e saktë edhe faktorigjina e tij nga Domgjoni i Mirditës, megjithëse kjo nuk bën fakt të kryer të jetë me etni mirditore. Këtu, nuk dua të analizoj e ta jap objeksionin tim se cila palë ka të drejtë dhe cila palë jo, por dua të theksoj faktin se në Zadrime sot ekzistojnë disa grupe etnike me dalluehmëri të dukshme në elementet kryesore që përcaktojnë etninë e një grupi njerëzish. Po cilët janë këto elemente?

Elementet më të qenësishme që bëjnë dallimin janë tri kryesore:

Gjuha që flasin njerëzit e atij grupimi;

Traditat dhe **zakonet** që kanë dhe i zbatojnë;

Veshjet e tyre tradicionale.

Duke u nisur nga elementi i parë të gjithë ata/o që flasin si gjuhë amtare gjuhën shqipe, kanë etni shqiptare. Këtu nuk mund të përfshihen të huajtë me kombësi të tjera, por që e kanë mësuar gjuhën shqipe, ashtu si anasjelltas, shqiptarët që kanë mësuar dhe flasin gjuhë të tjera të botës të jenë të atyre kombësive. Sot një pjesë e madhe e shqiptarëve kanë emigruar nëpër botë dhe janë të detyruar ta mësojnë e të flasin gjuhën e atij vendi ku jetojnë e punojnë, por kjo nuk i bën italianë, ata/o që jetojnë e punojnë në Itali, as grekë të tjerët që punojnë e jetojnë atje, as afrikanë disa që kushedi se ç'erë i ka hedhur në ato vende, e as anglezë, gjermanë, francezë e amerikanë ata/o që punojnë e jetojnë në ato vende përkatëse. Madje, do të thosha, as fëmijët e tyre të lindur në ato vende, veç në mos konsiderohen të tillë fëmijët e lindur nga familje të përziera.

Pra, për të gjithë ne që kemi lindur në Shqipëri dhe flasim shqip, pavarësisht se ndonjëri prej nesh, apo shumë prej nesh kemi marrë nënshtetësi të ndryshme, i përkasim grupit etnik shqiptar. Ky është grupimi më i madh që na përket të gjithëve. Megjithatë, etnia jonë degëzohet edhe me grupe dhe nëngrupe të tjera më të vogla të cilat kanë dallime esenciale mes tyre. Gjuha, zakonet dhe traditat e përbashkëta të një populli kanë përbërë atë që të përcaktohet edhe termi, apo thënë ndryshe, nocioni komb dhe ne shqiptarët, brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë, kemi kombin tonë që është

kombi shqiptar, ndaj thuhet: shqiptarët e Shqipërisë, shqiptarët e Kosovës, shqiptarët e Maqedonisë, shqiptarët e Malit të Zi e me radhë duke përmendur vendet ku ata jetojnë. Së fundmi përdoret edhe termi shqiptarët e diasporës, për ata/o që jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë. Duke iu referuar vendeve ku jetojnë shqiptarët e diasporës përreth Shqipërisë, shpesh kemi përdorur edhe termin Trojet Etnike dhe janë bërë edhe harta të ndryshme të asaj që mund ta quajmë Shqipëria Etnike. Një të tillë po e paraqesim këtu më poshtë dhe i takon vitit 1881 e gjetur në arkivat ruse.



Megjithatë, kombi ynë është konceptuar si i ndarë në dy grupime të mëdha sipas dallimeve gjuhësore, apo nuancave dalluese gjuhësore mes këtyre dy grupimeve që nga ana tjetër janë përcaktuar si dy dialektet gjuhësore të cilat janë gegë e toskë. Këto dallime nuk janë edhe aq të theksuara, sa mund të jenë në disa kombe të tjera, por, pa diskutim, ka dallime mjaft të qenësishme, sa nganjëherë një banor i ekstremit verior e ka të vështirë të kuptojë qartë një banor të ekstremit jugor të Shqipërisë. Nuk është krejt e rastësishme që jugorët ankoheshin se e kanë të vështirë t'i lexojnë veprat e At Gjergj Fishtës, pse nuk e kuptojnë gjuhën e përdorur në shkrimin e tyre edhe pse ato janë shkruar shqip dhe jo në ndonjë gjuhë tjetër.

Duke u nisur nga pikëpamja e dy dialekteve, studiuesi dhe themeluesi i shkencës së etnografisë shqiptare, Rrok Zojzi, në vitin 1962 tek libri Etnografia Shqiptare, në mes të tjerave tek artikulli i tij mjaft i detajuar “Ndamja Krahinore” shkruan: *“Për krahinë etnografike kuptojmë njësitë e vogla ekonomike shoqërore që u formuen historikisht në gji të një populli me jetë ekonomike, teritor, drejtim politik etj, të veçanta nga krahinat e tjera të krijueme në gji të tij. Këto krahina, me gjithë që kanë një bazë etnike të përbashkët, si rrjedhim i kushteve të veçanta të jetës, i marrëdhënieve të veçanta ekonomike shoqërore, i fateve të veçanta historike etj., krijuen në mes të tyre edhe **nuanca të lehta gjuhësore**, ndryshime të vogla*

*traditash kulturore etj., që u shprehën edhe me ndërgjegje shoqnore dhe me emën të tyre të veçantë. Në popullin tonë gjatë shekujsh u **formuen mjaft krahina etnografike** të tilla, disa nga të cilat, në formë mbeturinash, rrojtën deri afër nesh si, p.sh., Luma, Martaneshi, Verça, Kurveleshi etj.” (Rrok Zojzi, Etnografia Shqiptare 1962 fq. 16)*

Diku më poshtë, duke vazhduar analizën e tij shkencore në ndarjet dhe nëndarjet etnografike të popullit shqiptar, etnografi Rrok Zojzi thekson: “Nga pikëpamja historike-etnografike vetëm një nëndamje e madhe njihet në gji të popullit shqiptar: Veriu i Shqipnisë, që quhet “**Gegni**” ose “Gegëri” dhe jugu i saj, që quhet “**Toskëni**” ose “Toskëri”, Vetëm këto qenë grupe të mëdha krahinash etnografike që u paraqitën në prakun e zhvillimit kombëtar të popullit tonë dhe morën pjesë në formimin e tij kombëtar. Këto dy grupe krahinash etnografike gëzuen për një kohë historike jetë ekonomike, territor, ndërgjegje, drejtim politik etj. të veçanta, të cilat u shprehën edhe me të folme tradita kulture dhe emna të veçant.” po aty fq. 19. Sipas Rrok Zojzit, këto dy krahina Toskëri e Gegni, krijuan dallime të qenësishme mes tyre si:

-në gjuhë e cila qe e para që krijoi dy dialektet e mëdha: Gegë e Toskë;

-në kulturë materiale, në veshjen e burrave: në Veri me qeleshe dhe çakçirë (tirq); në Jug me takie dhe fustanella;

-në kulturën artistike në Toskëri mbizotëron polifonia, në Gegni mbizotëron muzika omofonike. Megjithatë, këto dy grupime, asnjëherë nuk janë quajtur si krahina etnografike, por si grupe krahinash etnografike, pasi brenda tyre ka edhe nënndarje krahinore me tipare të veçanta etnografike e këtu për ta pasur parasysh më qartë, mund t'u referohemi krahinave tona në Veri: Zadrimë, Mirditë, Malësi e Madhe e plot të tjera rreth nesh.

Duke i hedhur një vështrim më të hollësishëm ndarjes etnografike të Gegnisë, Rrok Zojzi e ndan në këto krahina të mëdha:

Gegnia që i dha emrin krahinës dhe që shtrihet në brigjet veriore të Shkumbinit.

Leknia ose Dukagjini që shtrihet në brigjet jugore të Drinit.

Malësia që shtrihet në Alpet e Veriut dhe në brigjet e Liqenit të Shkodrës


Fushat bregdetare përendimore që nuk formojnë një unitet etnografik, por paraqiten si njësi të vogla e të shkëputura në mes tyre. Këtu futet edhe Zadrima.

Fushat lindore (Rrafshi i Dukagjinit dhe Fusha e Kosovës).

Me gjithë këtë nocion ndarjesh, duhet të dimë se jo vetëm Fushat Perëndimore Bregdetare kanë nënndarjet e tyre etnografike, por edhe disa të tjera ndarje e nëndarje krahinore. Kështu kemi krahinën e madhe të quajtur Lekni, apo Dukagjin që përfshin disa nëndarje

me dallime të dukshme kulturash të ndryshme si gjuhë, tradita e veshje. Po ta analizojmë këtë krahinë, gjejmë ndryshime thelbësore mjaft të dallueshme sidomos në veshje, por edhe në nuanca gjuhësore. Kështu, ajo pjesë që sot ka koncept të ngushtë Dukagjin, nga ajo që quhet Mirditë, edhe pse që të dyja si krahina janë të përfshira në atë ndarje krahinore që quhet Lekni, ose Dukagjin, ka dallueshmëri mjaft të dukshme si në gjuhë, ashtu edhe në veshje, sidomos në veshjen e gruas. Në Dukagjin gruaja vishet me xhubletë, jo shumë të dallueshme me gratë e Malësisë së Madhe, ndërsa gratë mirditore nuk e përdorin xhubletën. Vetë dukagjinasit nuk e pranojnë të kenë vëllazëri me malsorët e Malësisë së Madhe, por e pranojnë dhe e thonë se e kanë vëllazërinë me mirditorët. Sipas gojëdhënave të tyre, thuhet se tërë krahina e tyre u formua nga një baba që kishte tre djem. Për këtë le t'i hedhim një sy këtij dokumenti nga “Etnografia Shqiptare”, por më parë duhet të shtojmë se nga ky dokument autokton kemi një informacion me shumë rëndësi, por duhet të sqarojmë se çfarë Rrok Zojzi konceptonte me termin “anas”. Me këtë term ai nënkuptonte vendasit që ishin aty dhe të tjerët të ardhur të rinj. Pra në ato krahina nuk kishte këtë popullsi që ka sot, por të tjerë që, ose u asimiluan nga të ardhurit, ose u shpërngulën drejt fushave majtas e djathtas, drejt Lindjes dhe drejt Perëndimit. Po ashtu, edhe ardhjet e kësaj popullsie duket se janë të mëvonshme dhe jo të

hershme, jo krejt autoktone. Shih foton këtu më poshtë për ato çka thamë më sipër:



Gjithashtu, duke u bazuar mbi bazat e të dhënave historike dhe zhvillimeve të atyre ngjarjeve të mëdha të historisë siç ishin luftërat e mëdha pushtuese nga romakët, nga sllavët, nga turqit më vonë, dhe sipas pushtimeve të gjata, popullsia e fushave u detyrua t'u drejtohej maleve duke u asimiluar nga popullsia vendase që gjetën atje dhe anasjelltas. Këto të dhëna janë mjaft të rëndësishme për të konceptuar faktet që

do të parashtrohen në këtë shkrim.

Historikisht njihet që në malet e Mirditës jetonte fisi i Pirustëve të përmendur si zejtarë të shquar për punimin e metaleve, por a janë mirditorët e sotëm pasardhësit e Pirusteve? Kjo mbetet për t'u studiuar. Unë nuk e kam këtë pikësynim, ndaj nuk do ta cek fare këtë fakt, as duke nxjerrë konkluzionet e mia e as duke iu referuar të dhënave historike të ndryshme. Objektivi im është të hedh dritë mbi grupimet etnike të Zadrimes së sotme dhe dallueshmëritë e të përbashkëtat që mund të kenë mes tyre si dhe evolimi e sheshimi i tyre.

Të gjithë e dinë se Zadrimea etnikisht, duke u bazuar në konceptimet e një ndarjeje etnike sipas tipareve që e përcaktojnë një grupim etnik të cilat kryesisht janë: gjuha dhe nuancat e veçanta gjuhësore; traditat dhe zakonet e veçanta; veshjet popullore, sidomos veshjet e grave, pasi veshjet e burrave, pothuajse ndryshojnë fare pak dhe nuk përbëjnë ndonjë dallueshmëri të veçantë, gjejmë tre grupime të mëdha që përbëjnë popullsinë e Zadrimes. Megjithatë, veç këtyre grupeve të mëdha, ka edhe grupime të vogla e jo krejt të pandjeshme.

Kështu, sipas të dhënave kryesore të tipareve të grupeve etnike, pjesën më të madhe e zë **etnia zadrimore** e cila dallohet dukshëm nga grupet e tjera etnike që e popullojnë Zadrimën. Nuk mund ta them me saktësi, por mendoj se kjo etni është shumica dhe gati 70% e popullsisë aktuale, ndoshta më shumë, ndoshta më pak se aq. Shumica dërmuese e fshatrave të

Zadrimës është e populluar dhe tradicionalisht i përket kësaj etnie.



Siç shihet nga kjo foto, gratë zadrimore kanë veshje krejt të veçanta, por edhe burrat dallojnë, se zakonisht, në vend të tirqve, veshin brekesha të bardha dhe në kokë mbajnë qeleshe karakteristike. Megjithatë, ka plot që përdorin edhe tirq, si shumica e veriorëve të tjerë.

Grupi i dytë etnik me tipare krejt të veçanta nga ato të Zadrimës dhe me një popullsi me një numër mjaft të konsiderueshëm është edhe popullsia e tre fshatrave rrëzë Velës siç janë Kallmeti, Rraboshta dhe Merqia. Si shihet, kjo etni është e përfshirë dhe e grupuar veç në tre fshatra të vetëm që mund të kenë përzierje mjaft të vogla etnish të tjera (Mirditë, Zadrimë). Këtë grup etnik mund ta quajmë **kallmetorët e Zadrimës**.



Në këtë foto paraqiten disa fëmijë e gra kallmetore. Aty shihen edhe dy gra të etnive zadrimore e mirditore.

Grupi i tretë etnik është grupimi mirditor që është futur në gji të popullsisë së Zadrimesë, ose në ishuj të vegjël anësorë. Si zakonisht, ky grup etnik, është nga ajo pjesë e popullsisë që ka rënë nga fshatrat e Mirditës e të Pukës më vonë se popullata tjetër e asimiluar në kohë nga anasit e hershëm. Fjala është për atë grup familjesh që në Zadrime kanë rënë një shekull më parë e në vijim deri në ditët e sotme. Kjo popullatë, qoftë në ishuj të vegjël, siç është rasti i Dragushës me popullsi të etnisë mirditore dhe fare të papërzier, apo fshatra të tjerë ku kjo popullsi është mjaft e konsiderueshme, ka ruajtur të paprekura traditat, zakonet, gjuhën dhe veshjet mirditore, pra, janë përcaktuar qartë si etni më

vete mirditore në Zadrimë, ndaj fare mirë mund t'i quajmë si **mirditorët e Zadrimës**.

Po t'i pyesësh se çfarë janë, ata të përgjigjen se janë zadrimore, megjithse në gjuhë zakone e veshje janë me etni mirditore. E thonë se janë zadrimore, jo pse ndiehen ashtu, por se ata kanë lindur, janë rritur dhe shkolluar në Zadrimë, pra se janë pjesë e Zadrimës. Po kështu të përgjigjen edhe kallmetorët. E them këtë, pasi kam pyetur edhe të moshuar/e kallmetor/e dhe më janë përgjigjur se janë zadrimore, megjithëse tiparet etnike i kanë të ndryshme nga zadrimoret. Këtë e kam të ditur edhe nga jeta dhe përvoja ime personale dhe nuk kam pse të mos e paraqes këtu edhe si fakt. Nëna ime ishte bijë Kallmeti. Nëna e saj (gjyshja ime e mirë), motrat e saj si dhe kunata, kishin veshje kallmetore që ndryshon kryekëput me atë zadrimore. Në shtëpinë e babait tim ajo kishte ardhur me veshje zadrimore dhe vdiq në moshë të thyer po me atë veshje. Megjithatë, nuancat e saj gjuhësore, megjithëse kaloi afërsisht 60 vjet mes nesh që flisnim gjuhën zadrimore, nuk ndryshuan deri në vdekjen e saj. Si nëna ime, Kodheli, një fshat mjaft i vogël, pati edhe katër apo pesë gra të tjera me origjinë nga zona kallmetore që e ndryshuan veshjen duke e ndërruar nga kallmetore në zadrimore, por gjuhën e ruajtën, për traditë, apo për vështirësi shqiptimi. Kur them për Kodhelin, një fshat i vogël në mes të Zadrimës, besoj se edhe fshatrat e tjerë duhet të kenë pasur kesi eksperiencash të lidhjeve martesore me ato

fshatra me tradita kallmetore, më rrallë me ato të tjerat me tradita mirditore, po jo fare.

Pakica të tjera etnike janë edhe ato të Malësisë së Madhe që përgjithësisht janë në zonat periferike siç janë Kukli, Kakarriqi, Gocajt dhe Balldreni, megjithëse dikush-dikush këto territore nuk i quan Zadrinë, por nuk mundemi as t'i quajmë ndryshe, pasi ajo popullsi është e rënë nga Malësia e madhe dhe u ngulën aty, ose duke blerë tokat e vendasve që duhet të kenë qenë zadrinorë, ose gjetën toka të lira, ose i grabitën me luftë duke i dëbuar vendasit nga tokat e tyre. Kjo e fundit nuk besoj se ka ndodhur, ndërsa dy rastet e para mundet plotësisht. Kjo vërtetohet edhe nga vetë fakti se në Kakarriq ka pasur edhe duhet të ketë akoma popullsi të etnisë zadrinore, megjithëse, në dijeninë time, në minorancë. Këtë mund ta ilustrojmë edhe me foto të ndryshme të vjetra grash zadrinore nga Kakarriqi, por besoj se edhe banorët e atij fshati mund ta konfirmojnë këtë gjë.

Në Zadrinë, banorët e zonës së Bregut të Matës, asaj zone që jeton në fushën mes dy lumenjve, Drin e Mat, i quajmë malësorët e Bregut të Matës. Sipas kësaj logjike, edhe banorët (malësorët) që jetojnë në Balldre, Kakarriq e Gocaj duhej të quheshin malësorët e Zadrinës, pse jo. Edhe fakti se atje jetojnë zadrinorë, nuk ka si të quhet ndryshe ajo zonë. Megjithatë, edhe pse malësorët e Zadrinës jetojnë gati në ishuj të veçuar, ka pasur edhe nga ato familje që me kalimin e

kohës janë absorbuar e konvertuar në etni zadrimore në disa fshatra të ndryshëm të Zadrimesë.

Përveç këtyre etnive që përmenda pak më sipër, ka edhe një pakicë popullsie që mund të jenë anas mjaft të hershëm, por me kohë janë konvertuar në muhamedanë dhe veshjen e traditat, tashmë nuk i kanë si asnjëra prej këtyre etnive. Po ç'janë kjo pjesë popullsie? Sigurisht, ajo pjesë e popullsisë që kanë përqafuar islamizmin të nxitur nga pushtuesi turk, o me dhunë, o me stimulime ekonomike, pjesa më e madhe kanë qenë zadrimore të vjetër, pra anas, me zakone, tradita e veshje zadrimore, por që duke iu përshtatur fesë që ata përqafuan, morën dhe bënë të vetat zakone e tradita të tjera. Në fakt, veç veshjeve dhe zakoneve në ritet e ndryshme, ata ruajtën të paprekura gjuhën zadrimore me të gjitha nuancat e saj karakteristike.

Shumë fshatra të Zadrimesë, në hershmëri, sipas gojëdhënave, por edhe sipas toponimisë që ka arritur deri në kohërat e sotme, kanë qenë popullsi me fe islame dhe kjo si pasojë e pushtimit turk të Shqipërisë. Kjo popullsi, duke mos duruar trysninë e këtij pushtimi u detyrua, ose të shpërngulej drejt maleve, ku jeta nuk mund të bëhej aspak e lehtë, ose të pranonte kushtet e pushtuesit dhe ta ndërronte fenë që të kishte favore e të mbijetonte. Nuk është gjë e pangjarë që aty të kenë sjellë edhe kolonë nga krahina të tjera që më në fund e kishin pranuar fenë islame, por një fakt është, se më vonë, pjesa më e madhe e kësaj kaste popullsie, iku

dhe u shpërngul në qytete të ndryshme të Shqipërisë që në epokën e pushtimit turk dhe kjo për kushte më të mira jetese, sidomos në qytetin e Shkodrës. Nuk është krejt e rastit që në Shkodër, sidomos, por edhe në qytete të tjera gjenden mjaft familje që mbajnë si mbiemra familjare emrat e fshatrave të Zadrimës si Fishta, Krajni, Dragusha, Troshani, Kotri, Nënshati, Dajçi, Kodheli, Gramshi, Mjeda, Shelqeti, Barbullushi, Pistulli, Laçi, Jubani, Spathari, Ashta, Bushati, Beltoja, Berdica, Kukli, Stajka, Zojzi, Shirqi, Vukatana e shumë e shumë të tjera si këta mbiemra. Një pjesë prej këtyre familjeve që mbajnë këta mbiemra i përkasin fesë islamike, gjë që do të thotë se ishin muslimanë nga këta fshatra të fushës së Zadrimës. Pra zadrimorë të hershëm katolikë të konvertuar në fenë islame.

Megjithatë, jo krejt popullsia myslimane e Zadrimës u shpërngul drejt qytetit, pasi pati edhe mjaft familje që qëndruan, punuan e jetuan në Zadrimë në bashkëjetesë me zadrimorët e fesë katolike, asaj pjese që i kishte rezistuar presionit të pushtuesit, si edhe asaj pjese që pat rënë nga malet duke blerë tokat e të ikurve, ose duke hapur toka të reja, ose edhe si çifçinj në toka pasanikësh.

Duke qenë se feja ishte mjaft e theksuar, marrëdhëniet mes popullsisë myslimane dhe asaj katolike mbetën në stadin e fqinjësisë dhe të bashkëjetesës fetare pa pasur lidhje më të ngushta siç ishin lidhjet martesore. Kjo bëri që të mos shkrihej hendeku mes kulturave dhe të

riktheheshin në zakonet, traditat dhe veshjet e vjetra të traditës etnike zdrimore. Kështu, sot kemi disa familje, ose disa fise nëpër disa fshatra të Zadrimës që kanë si religjion fenë islame, por jetojnë në harmoni të plotë me banorët që kanë si religjion fenë e krishterë. Këto familje janë sidomos në fshatrat Kotërr siç janë Zyberët, në Mabë Shahnët dhe në Shkjezë, në Barbullush, Bushat, Trush, Berdicë, Kosmaçë, Ashtë, Mjedë e në disa fshatra të tjerë, por ka plot fshatra që, edhe pse në kohën e pushtesit turk ishin plotësisht, ose pjesërisht me popullsi myslimane, sot nuk ka asnjë familje të atij besimi si në Kodhel, Baqël, Fishtë, Krajën, Dragushë, Gramsh, Dajç, Blinisht, Piraj, etj.

Ndryshe nga dukuritë e popullsisë së Zadrimës që, kur një pjesë u konvertua në fenë islame, e ndryshoi veshjen, traditat e zakonet, por jo gjuhën, popullsia e Malësisë së Madhe, edhe pse një pjesë nuk rezistoi, por u konvertua në fenë islame, nuk e ndryshoi veshjen, as gjuhën, zakonet e traditat e hershme. Kështu, atje prapë u përdor si veshje karakteristike xhubleta në të dyja pjesët e popullsisë, si të asaj të fesë katolike, si të asaj të religjionit islamik.

LËVIZJET DEMOGRAFIKE

Para se të flasim për lëvizjet demografike në Zadrimë edhe më gjerë, duhet të flasim më parë për rrethanat historike të cilat e përshkuan Zadrimën dhe mbarë

vendin përgjatë epokave të ndryshme, por më tej do të na duhet të hedhim dritë edhe në disa rrethana të tjera që ndikuan së tepërmi në lëvizjet e mëdha dhe të vogla demografike të popullatës, të cilat janë: kushtet klimatike e natyrore: rrethanat politiko-shoqërore, etj.

Mund të themi se Zadrimea ka qenë e populluar që në muzg të shekujve dhe këtë e dëshmojnë zbulimet e ndryshme arkeologjike e sidomos tumat ilire në vende e fshatra të ndryshëm të Zadrimës. Mjaft të përmendim gjetjen e statujës së lashtë në Gur të Zi të Shkodrës, apo zbulimet arkeologjike në Gajtan të Shkodrës, në Troshan të Lezhës e shumë vendeve të tjera përgjatë Zadrimës e mund të formojmë koncepte mjaft të qarta për hershmërinë e jetës njerëzore në zonën tonë. Nga ana tjetër, duke iu referuar edhe epokës ilire dhe luftërave të ndryshme që u zhvilluan në territoret e Zadrimës, përsëri mund të themi se edhe ato fakte janë dëshmi e një jetese të hershme.



Kjo foto është një afresk ku paraqitet Princesha e Zadrimës, Jerina e Gjergj Dushmanit, Prijësit të Zadrimës të periudhës së Mesjetës, periudha e kohës së para e gjatë pushtimit turk. Siç shihet, megjithëse është veçse një pikturë, dallohen qartë ato

tipare të qenësishme të veshjes autoktone zadrimore në dallueshmëri të plotë me tiparet e veshjeve të grave nga krahina të tjera shqiptare.

Studiues të ndryshëm të epokave të sotme kanë hedhur idenë se Fusha e Zadrimes, dikur në parahistori ka qenë një gji deti dhe se nën ndikimin e vazhdueshëm të lumenjve malorë Drin e Gjadër, si dhe disa përrenjve që bien drejtpërdrejt nga malet që e rrethojnë këtë fushë, nga Vela, Kreshta, apo Shita, është formuar gradualisht edhe e gjithë hapësira fushë në rrjedhjen e poshtme të këtyre lumenjve e përrenjve malorë. Megjithatë, po t'i hedhim një sy të gjithë kësaj hapësire, mospërmasaj shohim mjaft kodra e kodrina që mund t'i mendojmë edhe si ishujt e vegjël në atë gji deti të dikurshëm dhe dashje pa dashje mund të na shkojë mendimi se edhe ato kodra mund të kenë qenë vendbanime të hershme edhe para se fusha ta ketë marrë formën që sot ka. Kjo ndoshta edhe jo, pasi jeta njerëzore në ato treva në ato periudha, që mendohet se fusha e tëra ishte e zhytur nën ujëra, ende nuk ishte dukur aty, por më vonë, kur uji filloi dalëngadalë t'ia linte vendin tokës lymore të krijuar nga aluvionet e zajet e sjella nga lumenjtë e përrenjtë që e përshkojnë fushën e Zadrimes.

Duke e menduar të vërtetë faktin që solla më sipër, mund t'i drejtohem edhe toponimisë së vendeve dhe emrave të fshatrave që u krijuan gradualisht në kohë të ndryshme. Bie fjala, emri Kallmet ka ardhur si formë

përfundimtare e një fjalie “Në kallm mbet”. Sipas gojëdhënave të hershme, thuhej se njerëz të ardhur aty që nga thellësia e maleve në kërkim të mundësive më të mira jetese, iu përveshën punës për të hapur toka të reja bujqësore në vende të lira, por që ishin kallamishta kënetash dhe që në gjuhën e popullit quhej kallm. Aty u vendosën banorët e parë të zbritur nga malet e krijuan kushte jetese për të qëndruar përgjithmonë. Pjesa tjetër e familjarëve të mbetur mes malesh, kur pyeteshin nga fqinjët, apo miqtë e tyre, përgjigjeshin: “Në kallm met!” e kështu u formua si emër vendbanimi e fshati, ku sot, në sqetull të malit të Velës kemi dy nga këto fshatra me të njëjtin emër: Kallmeti i Madh e Kallmeti i Vogël që së bashku formojnë një nga fshatrat më të mëdhenj të Zadrimës.

Po kështu mund të themi se edhe fshati Rraboshtë vjen nga togfjalëshi fjali “Ra poshtë”, që do të thotë Ra (zbriti nga malet) poshtë në fushë. Edhe për këtë fshat të vendosur mu në rrëzë të malit që është një vazhdim i Velës së Kallmetit vendosja dhe pozicioni gjeografik i tij flasin qartë për idetë e hedhura për një shfrytëzim të mundësive të jetesës nga popullsia që e populloi atë gradualisht. Mund ta themi se popullsia që erdhi aty, jo vetëm për faktin e atij toponimi, por edhe për etninë që ka në gjuhë, veshje e zazkone, duhet ta ketë origjinën nga e njëjta krahinë me ata që populluan Kallmetin, pse jo, një pjesë e kallmetorëve të hershëm, meqenëse edhe ky pozicion gjeografik e jep konceptin se është

më poshtë se Kallmeti, duke pasur parasysh rrjedhjen e lumit Drin. Pra, është edhe më poshtë rrjedhjes së atij lumi, edhe më afër tij, gjë që mund të mendohet se tokat atje u hapën më vonë se tokat e Kallmetit të lashtë.

Vela në vetvete është një emër që mund t'ia kenë dhënë detarë të ndryshëm që në muzg të epokave, ndoshta qëkurse mendohet që Zadrimea të ishte gjë deti, apo lumi Drin të ishte i lundrueshëm. Duke e parë formën e saj si vela të hapura në një direk anijeje, mund t'ia kenë atribuar atë emër. Por ka edhe një fakt tjetër që ende sot e kësaj dite mbetet një enigmë mjaft e panjohur dhe e pazbulueshme. Thuhet si gojëdhënë se në majën e atij mali kanë ekzistuar spirancë detare me gjithë zingjirë të ngulur në shkëmb dhe këtë e lidhin me ekzistencën e një kepi detar në parahistori ku aty ankoroheshin anije të ndryshme detare. Po të jetë diçka e vërtetë që ajo majë mali prej më shumë se 1 mijë e ca metrash (plot 1172 m mbi nivelin e detit) e lartë të ketë qenë dikur liman ankorimi anijesh, duhet të mendojmë versionin se edhe Vela nuk ka qenë asnjëherë aq e lartë dhe më vonë është lartësuar nga dukuritë natyrore. Është i ditur fakti se nga zhvillimet e brendshme nëntokësore janë krijuar edhe malet e larta, por kjo jo me një ditë, as me një vit e as me një shekull, por me mijëra e miliona vjet. Po në ato epoka të largëta, a ishte e zhvilluar industria e punimit të metaleve? Besoj se jo, por ka edhe në shumë vende të botës objekte tejet

enigmatike që shkencë e sotme ende nuk u ka dhënë përgjigje ekzistencës dhe kushteve në të cilat u krijuan ato objekte. Hamendësimi nuk na jep një përgjigje të saktë dhe unë nuk po mbështet asnjë argument të tillë këtu, pasi, fundja, ky nuk është objekt i këtij shkrimi.

Duhet të theksojmë edhe një fakt tjetër se pothuajse të gjithë fshatrat e Zadrimës janë të vendosura në vende të ngritura, ose kodra. Bëjnë përjashtime disa nga fshatrat e Bregut, siç janë quajtur në Zadrimë dhe Blinishti i vjetër që ishin ngulitur në brigjet e lumit Drin, apo Gjadër, por të tjerët si zakonisht kanë pasur ngulmime veç në kodra, apo rrëzë maleve dhe kjo për arsye të ujërave që e mbulonin fushën, apo vërshimeve të lumenjve.

Që në epokën Ilire vendi ynë u bë objekt betejash të përgjakshme dhe po kështu edhe Zadrima. Këtu nuk po ndalem t'i tregoj betejat me radhë, se nuk është ky qëllimi im, aq më tepër nuk dua të përsëris të tjerët që i kanë theksuar ato në shkrimet e tyre, qoftë kur kanë folur për luftërat iliro-romake, qoftë për pushtimet serbe dhe më vonë ato turke, por dua të theksoj se këto luftëra të përgjakshme shpesh ndikuan edhe në lëvizjet e popullsisë në drejtim të maleve për t'u shpëtuar atyre gjakderdhjeve të pashmangshme. Dihet se në fusha ishte një rrezik i madh për banorët në kohëra luftërash që mund edhe të zhdukeshin, ndërsa malet, të vështira për t'u përshkuar lirisht nga pushtuesit, ishin streha më të sigurta për popullatën. Kështu, shumica e popullsisë

së Zadrimes, në ato periudha të errëta të jetës së tyre, iu drejtua zonave malore më të afërta duke lënë qoftë edhe përkohësisht trojet dhe ekonominë e tyre atje për t'u kthyer në kohë të mëvonshme e më të qeta. Nuk mund ta mendojmë se popullsia u dynd e tëra duke ia lënë vendin pushtuesit, por pjesërisht e përkohësisht. Ky fakt tregon edhe se tradita dhe kultura zadrimore u ruajt dhe u konsolidua pa ndonjë ndikim të fuqishëm nga ardhacakë të mëvonshëm. Kultura, traditat dhe zakonet e Zadrimes janë unike dhe të papërsëritshme e nuk mund të ketë mes malesh qoftë edhe një celulë të vetme të kësaj kulture e tradite që të mund të themi se është e mbartur prej andej nga dyndjet e reja që vinin nga zonat malore përreth saj.

Përsa i përket faktit të dyndjeve të përkohshme, fare lehtë mund ta argumentojmë me një fakt historik që ka ndodhur në fillimin e shekullit të kaluar në Zadrime e pikërisht në Dajç me luftën e përgjakshme serbo-turke të fillimvjeshtës së vitit 1912. Popullsia e Dajçit, duke e nuhatur situatën e përgjakshme që do të ndodhte në territorin e atij fshati, u dynd drejt malit të Nënshatit në pritje të përfundimit të asaj beteje të përgjakshme dhe qetësimit të situatës për t'u rikthyer atje pas tri a katër ditësh, kur lufta kishte marrë fund dhe aty nuk kishte mbetur gjallë këmbë ushtari nga asnjëra palë, veç të vdekur të panumërt që duheshin varrosur.

Si popullsia e Dajçit, shtëpitë e tyre i lanë edhe të tjerë fshatarë të fshatrave përreth Dajçit dhe u strehuan

ku mundën në vende më të sigurta. Pra ky ishte një fakt i njohur dhe i vërtetuar qoftë edhe për një betejë prej dy-tri ditësh, lë pastaj përgjatë betejave të përgjakshme që patën zgjatur me muaj e me vite e vite. Moskthimi i tyre drejt trojeve të lëna në fushë në kohë më të qeta do të thoshte pamundësi ekstreme jetese. Pra, kushtet e ndryshme historiko-shoqërore patën ndikuar së tepërmi në lëvizjet e popullsisë zadrimore drejt maleve, ku një pjesë u rikthye atje përsëri, ndërsa pjesa tjetër qëndroi e u asimilua nga popullsia vendase atje ku shkuan.

Për këto lëvizje të ndërsjellta na flet edhe etnografi i njohur Rrok Zojzi i cili thekson mes të tjerash:

“Popullsia e ardhun në viset malore u vendos pranë anasve të vjetër ku, si rrjedhim i bashkjetesës në një vend, u lidhën me interesa ekonomike dhe ushtruen një ndikim të fortë reciprok te njëri-tjetri në të folme, traditë kulture etj., aq sa u shkrinë në mes të tyne dhe formuen krahina etnografike të përbashkëta.

Ndërsa malet u ngarkuen dendun me popullsi, fushat kishin ngelë me një popullsi të rrallë që përbahej vetëm nga anasit që u shpëtuen luftave dhe emigrimit.”
(Etnografia Shqiptare 1962 faqe 22)

Ky konstatim i etnografit Rrok Zojzi vlen edhe për Zadrimeën dhe krahinat malore përreth saj, pavarësisht se ai këtë fakt e ka konstatuar për të gjithë Gegninë e jo veç për një zonë të caktuar. Me konceptin fushë ai ka parasysh si fushat përendimore bregdetare, ashtu edhe fushat lindore si Fusha e Kosovës dhe Rrafshi i

Dukagjinit përtej kufijve shtetërorë të Shqipërisë.

Diku më poshtë, duke folur për shpërnguljet e ndërsjella të popullatës, ai shprehet kështu:

*“Se kjo popullsi asht e ardhun nga fusha, vërtetojnë edhe traditat e saja. Në përgjithësi Dukagjini, me gjithë se sot banon në një zonë malore, nuk e quen vehten në asnjë rasë malësorë as vendin e tij malësi dhe për më tepër, po t'i quejsh banorët me këta emna, e marrin gati si të fyeme. Kjo popullsi, me gjithë se rron në një vend malor, të përshtatshëm për blegtori, ruen tradita aq të forta jete bujqësore, sa, kudo që të gjendet, mundohet të krijojë kushte jete bujqësore. Këtë e vërejtë edhe vetë populli që la fjalën: **“malësi shkon mbas bishtit të dhenit dhe dukagjinasi mbas bishtit të shatit”**,. Si Malësia ashtu edhe Gegnia, në të dy krahët e Dukagjinit, trashëguen grupimin shoqnor në **“male”**, të lidhun me kullota dhe jetën blegtorale, kurse Dukagjini që ndodhet në mes tyre, nuk e njih këtë grupim të jetës blegtorale as nuk trashëgon tradita nga ky organizim ekonomik-shoqnor.”*(Etn. Shq. fq. 35-36)

Duhet ta theksojmë edhe një herë tjetër se me termin Dukagjin, Rrok Zojzi koncepton brenda tij edhe termin Mirditë, si pjesë përbërëse të ashtuquajturës **Lekni** ose **Dukagjin**. Gjithashtu, si krahinë, Dukagjini nuk shihet veç ajo zonë që vetëm sot e gëzon këtë emër, por një zonë shumë më e gjerë se aq. Nga ana tjetër, ai na tregon edhe për një qëndresë mjaft të madhe dhe mjaft

të gjatë ndaj pushtuesve të huaj dhe po kështu edhe ndryshimet e kufijve dhe ndarjet e mëvonshme në krahina të tjera më të vogla, si dhe në rritjet e zgjerimet e kufijve në drejtim të krahinave fqinje, ose duke shtrirë traditat e zakonet e tyre në ato krahina, siç ishte rasti i Mirditës që nga tre bajrakë që ishte në fillim të herës me Orosh, Spaç e Kushnen, u bë me pesë, më pas me tetë e në fund me dymbëdhjetë bajrakë duke shtrirë, jo vetëm ndikimin e saj politiko-shoqëror, por edhe tradicional në gjuhë e zakone.

Meqë e theksuam faktin e dyndjeve të ndërsjella të popullatës së krahinave malore e fushore drejt njëra-tjetrës në kohë të ndryshme sipas kushteve shoqërore, historike dhe ekonomiko-natyrore, mund ta theksojmë se krahina e Dukagjinit, apo Leknia, duke qenë një nga krahinat më të mëdha si hapësirë, por edhe si popullsi, ishte një nga principatat më të fuqishme dhe nën princa të dinastisë së Dukagjinasve, ku ndër më të fuqishmit u shqua Lekë Dukagjini, bashkëkohës i Skënderbeut. Kjo principatë vazhdoi të qëndrojë e pamposhtur edhe kur e gjithë Shqipëria u pushtua e tëra nga Turqia, që në pjesën më të madhe e pushtoi dhe e nënshtroi, jo vetëm në fusha, por edhe në zonat malore. Kjo principatë, apo krahinë, thënë ndryshe, pasi tashmë pas pushtimit nuk mund të quhej më principatë, për dy shekuj me radhë qëndroi e pamposhtur dhe i hapte mjaft probleme e telashe turkut pushtues, pasi, mu mespërmes kësaj krahine shkante rruga Shkodër-Pukë-Va Spas-Prizren.

Sipas të dhënave historike, kjo krahinë kishte nën zotërimin e saj rreth 12 000 luftëtarë dhe, ashtu siç e cilësuam, përgjatë dy shekujve, jo vetëm që nuk u pushtua, por i nxori telashe Turqisë duke e bllokuar arterien kryesore të komunikimit, rrugën Shkodër-Pukë -Va Spas-Prizren që lidhte Veriun e Shqipërisë me Turqinë e asaj kohe. Por, ushtria turke, duke sulmuar nga të dy krahët e kësaj rruge, nga Kosova dhe nga Shkodra, pas afro gati dy shekujsh e bënë të mundur shbllokimin e kësaj rruge mjaft të rëndësishme për ta. Kështu, forcat e Dukagjinit u çanë përmes nga ushtria turke, ndaj u detyruan që me gra e fëmijë të tërhiqen më në thellësi të maleve, pjesërisht nga veriu e pjesërisht nga jugu, duke e lënë të pabanuar territorin djathtas e majtas rrugës së madhe. Përgjatë gjithë rrugës, ushtria turke vendosi garnizonet e saj e nga ana tjetër vendosi kolonë me bejlerë e agallarë që ishin edhe besnikë të betuar të tyre, me qëllim që, me anën e tyre, ta garantonin atë rrugë, arterie e rëndësishme për shtetin pushtues turk.

Kjo që sapo cilësuam, shpjegon edhe faktin se mospërmes kësaj krahine kemi një popullsi myslimane, kur e gjithë zona, majtas dhe djathtas kësaj rruge të vjetër, e tëra është e besimit të Krishtërë. Në thellësi të këtyre dy anëve, ushtria turke nuk arriti të depërtojë e të vendosë sundimin absolut të Perandorisë Osmane, pasi rezistenca popullore që e fortë falë edhe terrenit të thyer malor ku banonin ato popullata.

Nga kjo ndarje, mund të themi, se edhe traditat dhe zakonet mes tyre filluan të kanalizohen dhe të pësojnë zhvillime të reja, megjithëse duhet thënë se mjaft zakone e tradita në organizimin politiko-shoqëror nuk ndryshuan dhe qëndruan si njësi organizative siç ishte ndarja në bajrakë si dhe zbatimi rigoroz i Kanunit të Lekë Dukagjinit si rregullator i jetës shoqërore dhe politike të popullatës. Zakonet dhe traditat e zonave ku ata iu mbështetën, ose u përvetësuan pjesërisht prej tyre, ose ndikuan tek ata ku më vonë i përfshinë në territoret e tyre. Kështu, ajo zonë që quhet sot Dukagjin pjesërisht u asimilua në kulturën e veshjeve nga Malsia së cilës edhe i kishte marrë disa territore periferike. Mirdita, që i zgjeroi kufijtë e saj nga tre bajrakë që kishte fillimisht, në dymbëdhjetë që ka sot, bajrakët që iu mbështetën për t'u mbrojtur prej pushtuesit, morën edhe zakonet e traditat e asaj bërthame fillestare dhe kështu, sot, pothuajse kemi një Mirditë unike në traditë e zakone, si dhe gjuhë e veshje tradicionale.

Historikisht, Zadrима ka qenë një perlë më vete, jo vetëm për kushtet natyrore, gjeografike e ekonomike, por edhe për vlerat e saj kulturore, tradita, zakone dhe veshje të bukura të punuara mjaft artistikisht, ndaj nuk është pa domethënie që shumica e atyre që u ngulën me banim aty, u asimiluan në të gjitha aspektet e etnisë zadrimore e ne mund të themi me të drejtë se të gjithë ata që i kanë e i manifestojnë këto tradita, tashmë t'i quajmë anas, njësoj si ata që gjetën aty dhe ndikuan në

këtë drejtim të ngulitjes së zakoneve e traditave të tyre tek ata.



Edith Durham në Zadrinë në fillimshkullin XX.
Gjithashtu, duke qenë një perlë e veçantë e traditave e

zakoneve, Zadrима ka tërhequr vëmendjen, jo vetëm të fqinjëve të saj, jo vetëm studiuesve të ndryshëm, por edhe të ndërkombëtarëve. Nuk është pa domethënie që aty nga fillimi i shekullit XX, studiuesja dhe udhëtarja me famë botërore, anglezja madam Edith Durham e ka vizituar Zadrимën dhe zadrимorët e është mikpritur prej tyre bujarisht, ashtu siç janë traditat dhe zakonet e bukura të tyre.

Traditat, kultura, zakonet dhe veshjet zadrimore, janë bërë shpesh, jo vetëm objekt i studiuesve të ndryshëm në kohë të ndryshme, por edhe objekt i filmimeve të ndryshme përmes aparateve fotografike, apo kamerave, si dhe i mjaft artistëve, shkrimtarëve e piktorëve, pse ka qenë dhe mbetet një trevë mjaft e begatë kulturore në të gjitha drejtimet e saj. Nga kjo gjë, sot mund të shohim e sjellim në vëmendje mjaft shembuj ilustrues përmes këtij arsenali të madh dokumentar në kohë të vjetra, por edhe në kohët e sotme. Disa prej këtyre fotove do t'i sjell si shembuj ilustrimi këtu, për të dhënë konceptime sa më të qarta mendimesh e idesh që do të hedh më tej në këtë shkrim. Disa prej tyre mund të jenë nga arkivi im personal, por shumica të vjela nga rrjetet sociale që përdorues të ndryshëm i kanë publikuar në këto aty me të drejtën e copy right.

KUSHTET NATYRORE DHE EKONOMIKE

Zadrима, duke qenë një rrafshinë e ulët dhe më afër

detit se malet përreth saj, ofron kushte mjaft të mira klimatike që janë mjaft të pëlqyeshme për jetesë të popullatës. Vera është e ngrohtë, por edhe dimri është jo edhe aq i acartë sa në gji të maleve. Kjo ndikon edhe në resurset ekonomike duke siguruar kushte të mira për prodhimet bujqësore, por edhe për mbarështimin e gjësë së gjallë, që për zadrivorët mbetet gjithnjë një ekonomi shtesë në jetën e tyre, pasi primare është dhe mbetet bujqësia. Toka, gjithashtu është mjaft pjellore dhe prodhimet e saj të bollshme.

Këto kushte të favorshme që ka Fusha e Zadrimës kanë joshur vazhdimisht drejt saj popullsi të maleve që nuk mundeshin t'i kishin atje mes malesh. Në kohëra më të qeta, shtresa të ndryshme të popullatës së maleve iu drejtuan fushave, ose duke blerë tokat e atyre që vetë kishin emigruar në vende të tjera, sidomos drejt qytetit për kushte më të mira jetese, ose duke u futur si çifçinj në tokat e pasanikëve që kishin prona në Zadrimë dhe vetë jetonin në qytet, ose si hyzmetqarë në shtëpitë e zadrivorëve të kamur.

Si zakonisht, drejt Zadrimës kanë mësyer mirditorët dhe kanë emigruar aty në kohëra të ndryshme, ose me grupe familjesh a fisi, ose persona e familje të vetme e pa lidhje të veçanta. Ata që erdhën në Zadrimë më herët dhe u futën në gjirin e popullatës vendase, pak e nga pak u asimiluan nga anasit që gjeten aty, në gjuhë, në zakone, tradita e veshje tradicionale. Më pak u asimiluan ata që u ngulën në zona periferike apo ishuj

të veçuar, siç ishte Dragusha, si dhe ata që ranë në kohë të reja e të mëvonshme. Në disa fshatra të anës së malit ka plot familje mirditore që kanë zënë si zakonisht në vende periferike dhe kryesisht në rrëzë të maleve, apo edhe pak në lartësi të tyre, ku kanë gjetur vende të lira për të ndërtuar banesat e tyre pa shumë shpenzime. Kjo pjesë e popullsisë i ka ruajtur, jo vetëm traditat e tyre të hershme, por edhe lidhjet me pjesën tjetër nga kanë rënë duke marrë e dhënë nga ana ekonomike, por më shumë me lidhje martesore.

Emigrimet politiko-shoqërore si në kohërat e kaluara e po ashtu edhe në kohërat e tashme kanë ndodhur dhe vazhdojnë të ndodhin. Shumë familje si në të kaluarën, ashtu edhe në ditët e sotme, si shkak emigrimi mund të kenë edhe problemet e gjakmarrjes, ndaj kur kanë ikur, apo synojnë edhe sot të ikin nga vendbanimet e tyre të vjetra drejt vendbanimeve të reja, nuk lënë nga pas adresa nga ku shkojnë dhe kjo për arsye sigurie për të cilën janë të detyruar të largohen. Kështu, kur arsyet e emigrimit të tyre kanë qenë të kësaj kategorie, ato, në mënyrë të përgjithshme, i kanë shkëputur marrëdhëniet me vendbanimet e vjetra dhe banorët që kanë lënë atje. Edhe kjo gjë ka ndodhur si masë sigurie për jetën e tyre e të njerëzve pasardhës të tyre. Gjakmarrja ka qenë një dukuri mjaft e theksuar në Gegni e sidomos në Lekni, ndaj kjo ka bërë që të largoheshin edhe sikur kushtet ekonomiko-shoqërore t'i kishin pasur të favorshme në vend. Pra, si shkak dyndjesh të popullsisë, nuk kanë

qenë veç kushtet e vështira ekonomike, por edhe problemet e tjera shoqërore e politike.

Për kushte ekonomike, por edhe për arsye të tjera politiko-shoqërore e sidomos prej gjakmarrjes, shumë banorë të zonave malore i kanë braktisur vendbanimet e tyre duke boshatisur e shkretuar fshatra të tërë dhe kanë emigruar drejt fushës e sidomos drejt qendrave urbane për një mundësi jetese më të mirë edhe në epokën e sotme. Ky fenomen nuk ka ndodhur veç nga zonat malore që e kanë më tepër si një domosdoshmëri jetike, por edhe nga zonat e fushës që e kanë më pak të nevojshme se ato të atyre zonave problemin e mbijetesës. Madje, lëvizjet e sotme shpesh janë edhe paralele; nga një zonë urbane në një tjetër dhe kryesisht drejt metropolit që është sot Tirana e cila në ditët e sotme ka gati gjysmën e popullsisë që jeton brenda kufijve të shtetit shqiptar. Gjithashtu, mjaft familje shqiptare, nga të gjitha zonat e vendit pa përjashtim, për një jetë më të mirë, pra për kushte ekonomike, por edhe për probleme shoqërore e politike nga më të ndryshmet kanë emigruar drejt vendeve të ndryshme të botës dhe vazhdojnë të emigrojnë, sa sot me të drejtë mund të themi se gjysma e popullsisë e më tepër se aq ndoshta jeton jashtë në emigracion.

KUSHTET E REJA POLITIKE E SHOQËRORE

Në kohë të ndryshme, por sidomos gjatë gjysmës së

dytë të shekullit të kaluar, në të gjithë Shqipërinë, pa asnjë përjashtim, u diktuan ndryshime të mëdha në jetën e masave popullore, që çuan drejt një unifikimi të përgjithshëm në zakone e tradita, por edhe drejt një gjuhe të njësuar, sidomos pas Kongresit Drejtshkrimor në nëntor 1972. Me gjithë trysinë dhe diktatin e ashpër të ushtruar nga diktatura komuniste, përsëri u ruajtën të paprekura disa tradita e zakone që populli i manifestonte herë haptas e herë në mënyrë të maskuar. Këtu, mjaft të përmendim ruajtjen në mendje e në shpirt të besimit fetar, edhe pse shteti komunist e kishte ndaluar me ligj.



Nuk është e pa vend të ndalemi pak dhe ta analizojmë këtë fakt të përgjithshëm shoqëror, jo vetëm për një etni apo krahinë të veçantë, por për shmicën dërmuese të popullit. Shteti, siç e cilësova, e ndaloi me ligj fenë e institucionet fetare të çdo kategorie i mbylli, ose i shembi që në themele që në vitin 1967, por besimin nuk

arriti ta shuajë. Populli fshehurazi u përpoq t'i ruajë e t'i manifestojë po fshehtas, edhe pse mjaft martirë të fesë i kishin ekzekutuar me pushkatime e varje, sidomos

priftërinjtë, por edhe jo rrallë edhe ata që guxonin të dilnin haptas në mbrojtje të besimit fetar, sidomos të fesë katolike që ishte bazë për zonat e Mirditës, Zadrimës, Dukagjinit e pjesërisht të disa zonave të tjera jashtë tyre. Në atë fotografi shoqëruese të këtij paragrafi, as më pak dhe as më shumë, paraqitet një grua zadrimore duke u lutur para një murane që qe ngritur nga banorët e Kodhelit mu aty ku kishte qenë kisha e vjetër e fshatit e shembur nga regjimi komunist. Njerëzit, duke e pasur në shpirt besimin, me gurët e asaj kishe që patën shpëtuar pa u marrë dhe dërguar diku për të ndërtuar ndonjë stallë derrash, apo bunker strehimi në rast ndonjë lufte imagjinare, kishin ngritur mu në shesh një altar lutjesh. Fotoja e shpreh më së miri këtë gjë, jo vetëm rrënjosjen e besimit fetar, por edhe guximin e treguar nga zadrimorët që gati haptas i manifestonin bindjet e tyre fetare.

Ndikimi i shtetit të diktaturës nuk qe veç në zhdukjen e besimit fetar në popullatë, por edhe të zakoneve dhe traditave zonale e shoqërore. Kështu, u bë një luftë e madhe edhe në ndërrimin e veshjeve tradicionale, jo vetëm tek brezat e rinj, të cilët e pranuan, duhet thënë për hir të vërtetës, jo me ndonjë keqardhje të madhe, por edhe tek breznitë e moshuara që nuk e mirëpritën dhe këmbëngulën ta ruanin sa të ishte e mundur si tek vetja, ashtu edhe tek fëmijët e tyre traditën zonale të veshjeve, zadrimore, mirditore, kallmetore apo të çdo zone tjetër që i kishin pasur tradicionalisht.

Nga veshjet e bukura tradicionale, mbeti pothuajse vetëm kujtimi i tyre dhe lejoheshin veç kur bëheshin festivale folklorike, ndërsa në punë e kudo, sidomos gruaja duhej të vishte, siç i thoshin ato, pantallona e sipër tyre kotlla qytetarçe. Në vend të peshqirëve do të vendosnin shami faqelli, ose kokëzbuluar, çka nuk ishte normative për një grua, sidomos të traditës etnike zadrimore, pasi asnjëherë gruaja zadrimore nuk dilte pa peshqir, as në brendësi të familjes, lë pastaj të dilte në publik.



Brigada kooperativiste e Kodhelit. Brigadierit u lexon gazetën.

Në të shumtën e rasteve, brigadierët e brigadave të kooperativave bujqësore, me urdhëra të prera nga lart, i largonin nga puna, qoftë gratë, apo vajzat e reja që u

shkonin me veshje tradicionale popullore, qoftë gratë e moshuara që e patën mjaft të vështirë ta ndërronin veshjen dhe të visheshin ashtu si laraska, siç e quanin ato atë veshje të përçudnuar. Po mospjesmarrje në punë do të thoshte që të mos kishe me se të ushqeheshe, edhe pse me aq sa paguheshin, as bukën e gojës nuk arrinin ta merrnin nga kooperativa, prandaj u detyruan ta ndërronin me hir e pa hir veshjen tradicionale.



Në këtë foto shihen dy gra zadrimore me veshje tradicionale të moderuara. Aty shihet qart se si i kanë zëvendësuar peshqirët me shami dhe si i kanë lidhur ato mbi kokat e tyre.

Në fakt, ndërrimi i detyruar i veshjeve që një lehtësim për gratë në kushtet e jetesës që kishin, se të shkoje në

hapje kanalesh, apo korrje e zhveshje misri, shpeshherë edhe mes llucës e baltës, si dhe punëra të tjera të rënda që ishin të detyruara të bënin, nuk kishte se nga t'i shpëtoje ndotjes së rrobave, ndaj ajo veshje e detyruar në ato punëra që kooperativa i detyronte ato të bënin, ishte si një mburojë e veshjeve tradicionale që gratë e vajzat zadrimore, por edhe të etnive të tjera kishin.

Kooperativa nuk njihte e nuk kishte moshë pensioni, ndaj i detyronte edhe pleqtë e plakat të dilnin në punë, se ndryshe ua priste racionin e bukës së mykur që gatuhej nëpër furrat e saj të pjekjes së bukës dhe pa bukë nuk jetohej, ndaj edhe gratë e moshuara u detyruan që sipër rrobave të tyre tradicionale, të vishnin pantallona e kotlla, e në vend të rizave apo



peshqirëve, të vinin shami faqelli që përsëri i lidhnin jo shpesh nën gushë me një nyje, por i lidhnin sipër kokës duke imituar vendosjen e peshqirit. Në mjaft raste i lidhnin edhe duke i sjellë rreth qafës, sipas mënyrës së vendosjes së peshqirit në disa raste.

Një fakt të tillë mund ta vërejmë më së miri nga fotoja e mësipërme, ku

mes punëtorëve të brigadës ka edhe gra që përdorin shami në vend të peshqirëve tradicionalë, por edhe vajzash të reja që e mbulojnë kokën me shami, sipas traditës së hershme familjare, por edhe ndonjëra që nuk e përdor fare shaminë. Po kështu edhe kjo foto e tregon qartë se si përdorej shamia me të cilën gratë zadrimore zëvendësuan rizat e peshqirët tradicionalë të përdorura nga ato. Propaganda komuniste ishte, jo vetëm e zhurmshme, por edhe e dhunshme, ndaj ato që nuk i zbatonin urdhërat e Partisë në pushtet, mund ta pësonin mjaft keq, deri edhe me dënime me burgime, gjë që ka ndodhur jo rrallë.

Gruaja zadrimore kurrësesi nuk mund ta konceptonte të dalurit me kokë zbuluar brenda mureve të shtëpisë e jo e jo më në publik edhe kur krihej, apo rregullohej, vazhdimisht gjente ndonjë qoshe të shtëpisë të veçuar e larg syve të meshkujve të shtëpisë dhe po të rastiste që atje të shkonte ndonjëri prej tyre, qofshin këta edhe djemtë e vegjël që mund të ishin fëmijët e tyre, përsëri me të shpejtë e mbulonin kokën dhe kërkonin që ata të largoheshin prej atij mjedisi ku ato rregulloheshin. Kjo dukuri, mund të them se nuk ka ndodhur veç në zonën e Zadrimesë, por në të gjitha zonat e krahinat e vendit e kështu që u ndikua shumë në fshirjen e traditave dhe të zakoneve popullore duke humbur identitetin etnik të atyre krahinave që i patën mjaft të theksuara si Mirdita, Kallmeti, apo Malësia e Madhe e gjetk e jo vetëm në Zadrinë.

Deri aty nga gjysma e parë e viteve '60 të shekullit të kaluar, zedrimorët, as vajzave të tyre të moshave shkollore nuk ua patën ndërruar veshjet dhe në të gjitha shkollat gjeje vajza me veshje tradicionale, po më vonë u bë e detyrueshme që ajo veshje të ndërrohej dhe, po të ishte e mundur, të përdorej uniforma shkollore, madje edhe me detyrim. Kjo ndikoi që më pas të mos u ktheheshin më veshjeve tradicionale, veç në raste jo shumë të shpeshta e aspak masive.



Mbeti e pandryshuar tradita e veshjes veç tek gratë e moshuara, e sidomos tek ato gra që u martuan me veshjet tradicionale, por tek të tjerat, të moshuara, ose jo, pothuajse sot nuk përdoret fare veshja tradicionale, veç nëse i ruajnë nëpër garderobat e tyre si relike të një kohe të largët dhe mund t'i veshin veç në raste tepër të

veçanta. Rastet e veçanta si zakonisht ishin dasmat, por edhe në ditë të tjera festive dhe kjo ishte edhe sipas preferencave të njëjës grua apo tjetrës e jo në raste masive. Gjithashtu, kur organizoheshin evente sociale, si grupe folklorike, gjenin mundësinë e ato gra e vajza pjesëmarrëse në ato grupe i vishnin sa për ta kryer atë “detyrë” të ngarkuar nga partia dhe më pas i ktheheshin jetës normale, të diktuar po nga partia që jepte udhëzime e urdhëra si duhej veshur e si jo.



Gjatë një koncerti festiv në kohën e monizmit.



Viti 1991, mesha e parë pas diktaturës komuniste në Kodhel.



Grupi artistik i Kodhelit në vitin 1988.



Gra dhe vajza zadrimore nga Gjadri me etni të ndryshme.



Momente festive tek shkolla e mesme Blinisht.



Nxënësit e shkollës Hajmel duke manifestur traditat zadrimore.



Nxënësit e shkollës shtatëvjeçare në Hajmel në vitin 1957. Shikoni veshjet e tyre. Të gjithë i përkasin etnisë zadrimore.



Vajza me veshje zadrimore dhe mirditore nga Gjadri në ditët e sotme. Kultura dhe tradita mikse.



Gra zadrimore nga Dajçi.



Momente festive në një dasëm zadrimore.



Blinisht. Tek pallati i kulturës në vitet '70. Veshje karakteristike zadrimore.



Manifestim i kulturës popullore në shkollën e mesme të Dajçit

KATEGORITË ETNIKE TË ZADRIMËS

Pasi folëm për lëvizjet demografike të popullsisë dhe për shkaqet kryesore që i detyruan këto lëvizje në kohë të ndryshme, duke marrë parasysh ato lëvizje që u bënë drejt Zadrimesë, pa analizuar rrjedhjet prej saj drejt vendeve të tjera, po paraqes edhe një herë kategoritë etnike që jetojnë aty dhe dukuritë në dallueshmëri mes tyre si dhe mendësitë e përgjithshme që i kategorizojnë ato kategori etnike.

Pa asnjë diskutim, ashtu siç e kam cilësuar që në krye të herës, kategoria etnike, apo grupi etnik më i madh në të gjithë popullsinë e Zadrimesë, është etnia

zadrimore. Kjo duket në mjaft veçori dalluese sidomos në gjuhë, veshje e zakone. Me përjashtim të fshatrave Kallmet, Rraboshtë, Merqi, që janë të etnisë kallmetore me veshje, tradita, zakone e nuanca gjuhësore ndryshe nga pjesa tjetër, si dhe Dragushës me etni zakonesh, traditash e veshjesh mirditore, pjesa tjetër e Zadrimës, ose ka etni të pastër zadrimore me veshje, tradita, zakone dhe nuanca gjuhësore karakteristike, ose ka aty – këtu edhe pjesë minore popullsie të etnive të tjera e me mazhorancë të etnisë zadrimore. Gjithashtu, nga kjo krahinë mund të quajmë përjashtim edhe zonën e Përtejdrinit si Balldre, Gocaj, Kakarriq e Kukël. Edhe zona tjetër në perëndim të lumit Drin ka karakteristika pothuajse të njëjta me pjesën e anës lindore të Drinit me pak ndryshime, sidomos në ndonjë element gati të parëndësishëm në dukje veç në veshjen tradicionale të vajzave dhe grave. Ky ndryshim është më së shumti tek madhësia dhe forma e bohçes që përdorin ato, megjithëse, duke iu referuar kohërave të ndryshme, ky ndryshim ka ardhur gjithnjë e duke u thelluar më shumë deri në ditët e sotme. Përsa u përket nuancave gjuhësore janë po ato që shfaqen edhe në anën tjetër e po kështu edhe traditat dhe zakonet e të dyja anëve janë të njëjta. Problemi qëndron, se pjesa tjetër, d.m.th. ajo pjesë që jeton në anën perëndimore të Drinit, nuk e parapëlqen ta quaj vetën Zadrimë, çka mund të jetë vetëm çështje konceptimesh, të drejta ose jo, këtë nuk e shoh me vend ta shtjelloj këtu duke shprehur bindjen

time, pasi e kam bërë tashmë në librin tjetër me titull “Koncepti Zadrime” dhe nuk dua ta përsëris vetveten.

Megjithatë, duke u bazuar në shumë argumenta dhe fakte nga më të ndryshmet, e kam mbështetur gjithnjë konceptin tim të pandryshueshëm se në të dyja anët e Drinit popullsia i përket të së njëjtës etni popullore me fare pak ndryshim, jo në zakone e tradita, pasi ato janë të njëjta pothuajse, as në nuanca gjuhësore, pasi edhe ato nuk kanë dallime esencial, por, siç e cilësuam, veç në ndonjë element të veshjes së gruas, megjithëse edhe në zonën perëndimore të Drinit, në mjaft raste ka veshje të pastër zadrimore. Megjithatë, edhe pse ka ndonjë dallim të vogël, ngjashmëritë janë të dukshme. Për ngjashmërinë mes dy zonave mund ta vërtetojmë edhe me foton që po paraqes këtu më poshtë:



Shoqërimi i nuses zadrimore.

Përveç nuses zadrimore, aty janë edhe tri gra me etni zadrimore dhe një me veshje nga zona e Rranxave, e dyta nga e majta, ku dallimi në veshje duket vetëm tek bohçeja që ka veshur dhe kushdo mund të vërejë ndryshimin dhe po kështu edhe ngjashmëritë e plota të tyre në elementet e tjera. Po kështu, duke iu referuar edhe fotove akoma më të vjetra, gjejmë ngjashmëri edhe më të mëdha, qoftë edhe tek modelimi i bohçeve që përdornin gratë e zonës së Bushatit e të Rranxave, qoftë edhe në elementet e tjera të veshjeve. Më poshtë, për ilustrim, po paraqes edhe një foto tjetër për lexuesin e këtij shkrimi dhe aty, duke e krahasuar si janë të modeluara sot bohçet, mund ta vërejë vetë atë evolucion në kohë të veshjes së zonës së përtej Drinit.



Scutari - Costumi local

Në këtë foto të vjetër duket qartë që i takon zonës së Rranxave, apo Bushatit dhe këto gra e vajza nuk i kanë bohçet fare të shkurtëra, aq sa i kanë dhe i mbajnë sot.

Ndryshimi i vetëm tek bohçet që ato kanë veshur, është se janë të rrudhosura, ndryshe nga bohçet që përdorin zadrimoret e zonës lindore të rrjedhjes së Drinit. Këtë e tregojnë edhe fotot e mëposhtme ku duken grupe grash zadrimore me veshje tradicionale zonale dhe bohçet, përveçse nuk i kanë të rrudhosura siç i kanë gratë dhe vajzat e fotos së mësipërme, në gjatësi pothuajse nuk ndryshojnë fare. Kjo na jep të drejtën të mendojmë se edhe kjo dukuri është një stilim që ka ardhur duke ndryshuar në kohëra të ndryshme dhe aspak si element dallues që në hershmëri të këtij pellgu. Ndryshimi është thelluar më së shumti në epokën e sotme, pasi fotot e vjetra, fotot e para viteve '50 të shekullit të kaluar dhe më para se atë, e tregojnë këtë konstatim timin më së miri.



Foto e vjetër e zadrimoreëve të Vaut të Dejes



24/06/2012

www.deicampe.net

Pra, siç shihet edhe në këtë foto, elementet e veshjes së grave në shumicë, janë të etnisë zadrimore dhe jo të një etnie tjetër si mirditore, malësore e kallmetore.



Ne rrugen Barbullush-Busht ne vitin 1963 nje italian turist ben nje fotografi !



Ashtu siç e cilësova, etnia zadrimore në të gjithë pellgun e fushës midis dy qyteteve kryesore veriore

Lezhë e Shkodër, pra Zadrima, në shumicën absolute i përket etnisë zadrimore në tradita, zakone, veshje dhe gjuhë. Megjithatë, në fshatra të ndryshëm ka edhe disa elemente të etnive të tjera, sidomos asaj mirditore. Kjo dukuri shfaqet sidomos, përveç Dragushës me etni të pastër mirditore, edhe fshatra si Troshani, Fishta, Krajni, Nënshati, Hajmeli, Dheu i Lehtë, Ndaraçi, Laçi, Kaça, Dajçi, Maba, Gjadri, Zojzi, Paçrami e ndonjë tjetër fshat, ka ndonjë, apo disa familje me etni të tjera e kryesisht mirditore. Një pjesë tjetër dhe kryesisht Baqël, Blinisht, Piraj, Kodhel, Gramsh, Kotërr, etj. nuk kanë asnjë familje, apo grup familjesh mirditore.

Po t'i hedhim një sy kësaj harte, vërejmë si dukuri të veçantë të këtyre vendosjeve mirditore në Zadrimë. Së pari, vërejmë se shumica e instalimeve mirditore janë vendosje në fshatrat e anës së malit dhe pothuajse në periferi e jo në gji të popullsive të këtyre fshatrave. Pjesa dërmuese e tyre i takojnë Troshanit në pjesën e sipërme, kryesisht në faqe të malit dhe sipër rrugës automobilistike, Fishtës në mëhallën e sipërme. Edhe këtu sipër rrugës. Krajnit, ku shumica e tyre janë instaluar në gjysëm të malit siç janë edhe ato familje që janë instaluar në Nënshat. Në Dragushë janë vendosur plotësisht, pasi janë larguar banorët e mëhershëm të atij fshati, ndërsa në Ndaraç, Kaçë, Dheu i Lehtë, Laç, etj., siç duket ka ndikuar aty pozicioni gjeografik që është grykëdalja në fushë e lumit Gjadër që vjen nga zonat e Mirditës. Pra këto vërshime drejt këtyre fshatrave, si

zakonisht i përkasin fshatrave të zonës së Kashnjet, Korthpulë, Vig e Mnelë e ndonjë zonë tjetër e afërt si Dush e Kçirë të Pukës.

Po përse këtyre familjeve e grupfamiljeve të këtyre fshatrave u themi etni mirditore dhe pse e ruajtën ato etninë e origjinës nga erdhën?


Përgjigjen e gjejmë në disa faktorë, por kryesori është se ato familje ranë relativisht vonë në Zadrinë dhe nuk u shkrinë brenda etnive të tjera e qëndruan në periferi duke ruajtur marrëdhënie të forta me zonat nga ranë, meqë nuk ishin edhe aq larg prej tyre e duke qenë në periferi dhe jo në brendësi, nuk i krijuan lidhjet me etni të tjera, veç mes tyre. Kjo bëri që edhe lidhjet martesore të ishin të preferueshme pothuajse plotësisht veç mes familjeve me origjinë mirditore larg, ose afër tyre. Nga kjo gjë nuk u bë i mundur sheshimi i hendeqeve mes etnisë kryesore që është ajo zadrimore dhe asaj mirditore të mbartur që nga vendet nga vinin ato familje.

Ndryshe ndodhi mes zadrimorëve dhe kallmetorëve. Këta të fundit nuk u kufizuan në lidhje martesore veç mes tyre, por edhe me zadrimorët, megjithëse në raste jo fort të dendura, si dhe me mirditorët që mund të them se ishin më të shpeshta se me zadrimorët. Edhe kjo e ka një bazë logjike që është përshtatja në gjuhë e zakone më e madhe me mirditorët se sa me zadrimorët. Ndryshimi ishte veç në kostumografi. Tek kostumet tradicionale kallmetore mbizotëron ngjyra e bardhë,

ndërsa tek zadrivorët dhe jo pak tek mirditorët e kuqja.



Le të shohim këto foto krahasimie:



Veshje të nuseve kallmetore.



Nuse zadrimore.



Nuse mirditore.



Dy nuse zadrimore dhe një vajzë mirditore majtas dhe djathtas tri nuse mirditore.



Besoj se këto foto që paraqita këtu më sipër e tregojnë qartë dallimin etnik në mes etnive që e popullojnë sot Zadrimën, pa pasur nevojë për analiza e komente të veçanta pasi ndryshimet janë të dukshme.

Në fakt, aty më sipër paraqita veç veshjen e grave në disa etni, por dallime kanë bërë edhe veshjet e burrave, që duhet thënë se nuk kishin shumë dallime esenciale nga krahina në krahinë sidomos në Veri, por po t'i hedhim një sy më të vëmendshëm, edhe aty kemi me gjetë dallime esenciale. Disa nga ato elemente po i paraqes sipas karakteristikave të veçanta të veshjes së burrit zadrimor në kohët tradicionale, deri kur filluan ndryshime të dukshme duke shkuar drejt një unifikimi të vetvetishëm.



Zadrimorët si traditë dhe zakon në përgjithësi kishin që të mbathnin çorape të leshta me ornamente me ngjyra të ndryshme ku më shumë ngjyra e kuqe mbizotëronte. Etnitë e tjera

nuk e kishin këtë traditë, ndaj zadrimorit nga kjo iu vu edhe epiteti “çorapekuq” prej të tjerëve, pse shputat e atyre çorapeve ishin plot ornamente dhe kallmat e kuq. Në kohët e vjetra gjyshërit tanë, por edhe baballarët e arritën pak në fëmijërinë dhe rininë e tyre të hershme,

ndoshta deri pak para Luftës së Dytë Botërore, opingat i përgatitnin vetë me lëkura lope. Thoshin se nuk ishin edhe aq praktike, se dëmtoheshin shpejt. Më vonë doli mundësia të përgatiteshin opinga llastiku me goma makinash dhe ishin më të qëndrueshme se opingat prej lëkure lope.

Kur në Toskëri përdroreshin fustanella, në Zadrinë si zakonisht përdroreshin brekesha të bardha prej liri të cilin e prodhonin vetë nëpër tokat e tyre. Asokohe nuk njihej as pambuku dhe përdorej liri për të përgatitur rroba e takëme shtëpie.

Më vonë, kur doli pambuku si produkt për prodhim pëlhurërash, qepeshin edhe brekesha sakëzi, një lloj pambuku i trashë, por i kushtueshëm. Për bel ngjeshnin breza të linjta, jo për të mbajtur brekeshat ngjeshur për trup, pasi ato i lidhnin me ushkur, por për ta mbajtur trupin të ngjeshur. Kjo u jepte forcë e siguri në përballimin e punëve të rënda që u duhej t'i kryenin. Mbajtja e brezit ishte edhe për gratë zadrimore, ndërsa gruaja mirditore mbante atë që e qunin qemer.

Burrat zadrimore, zakonisht, mbanin veshur xhurdinj të zinj të përgatitur me lesh deleje, apo me fjolla liri dhe kjo për ta ishte një veshje tradicionale.



Këtë gjë e shihni edhe tek kjo foto e fillimshkullit XX ku paraqiten katër burra zadrimorë mjaft të njohur për kohën e tyre. I ulur është prijësi i çetës së komitëve të Zadrimës Shtjefen Preç Sallaku nga Blinishti i cili u kap tradhëtisht nga turqit, u dërgua në kala të Shkodrës dhe u torturua

barbarisht deri se vdiq. Të tjerët janë: nga e majta Zog Miloti dhe djathtas Gjok Paloci, një njeri i shquar për urti e mençuri, të dy këta nga Dajçi. Mes tyre nga pas paraqitet Hiluk Preçi nga Blinishti, edhe ky komit në çetën e Zadrimës që luftonte kundër sundimit turk të asaj kohe.



Shkurt Zeka, Kodhel me veshje tradicionale zadrimore.



Burra zadrimore me kostume popullore tradicionale.



Burra nga Kallmeti. Tradicionalisht mbajnë qeleshe rrashatuke.



Një familje e etnisë malësore me veshje karakteristike zonale.



Disa gra dhe vajza dukagjinase. Aty-këtu, edhe në Zadrimë ka familje të zbritura nga Dukagjini.

Krahas këtyre tri etnive që paraqita më sipër, duhet thënë se Zadrima, duke përfshirë edhe zonën e ngushtë përtej Drinit rrëzë malit të Kakarriqit dhe Balldrenit, ka edhe etni malësore. Popullsia e kësaj zone ka rënë nga Malsia e Madhe në kohë të ndryshme. Ashtu siç e kemi cilësuar, atje, ose blenë toka të zadrимorëve që qenë atje dhe u shpërngulën prej andej, ose duke ikur drejt qyteteve. Në parantezë, në Shkodër, por edhe në ndonjë qytet tjetër ka disa familje që mbajnë mbiemrin Kakarriqi. Ose ata banorë që ranë nga Malësia hapën toka të reja që ishin pyje, moçale e shkurrishte pa zot. Por një fakt qëndron se në dijen time në Kakarriq ka pasur dhe ka familje të etnisë zadrimore dhe jo vetëm të etnisë malësore që përbëjnë shumicën etnike atje.



Për këtë mund të them se jo pak raste ka pasur në lidhje martesore mes zadrимorëve, sidomos të fshatit Blinisht me zadrимorët e zonës së Kakarriqit. Po kështu, edhe një foto e vjetër që shihet aty në të majtë, paraqet dy gra zadrimore në fshatin Kakarriq që mund të dokumentojë këtë që e paraqita si fakt.

Duke u mbështetur për

nga hershmëria e ngulitjes së zakoneve dhe traditave, mund të themi se në Zadrimë mund të quajmë anas të hershëm atë pjesë të popullsisë të religjionit islamik, pasi vijnë nga vendasit e vjetër që nuk mundën t'i rezistojnë trysnisë së pushtuesit turk dhe e pranuan fenë e sjellë prej tyre në Zadrimë. E kemi thënë se ata iu larguan zakoneve e traditave të zadrимorëve të hershëm nga faktori fe, por kjo nuk do të thotë se nuk janë zadrимorë, madje ndër më të vjetër se të tjerët, së bashku me atë pjesë të popullsisë që ishte anase e vjetër dhe që i rezistoi konvertimit në fenë islame.

Por anas duhet të quajmë edhe atë pjesë të popullsisë që erdhi në Zadrimë gjatë Mesjetës së vonë dhe u asimilua në tradita, zakone, gjuhë e veshje nga anasit e vjetër dhe sot nuk praktikojnë zakone e tradita të ndryshme nga ata. Këtë e dëshmojnë qindra e mijëra zadrимorë që e dinë qartë se nga e kanë origjinën e tyre të largët, por që janë konvertuar në zadrимorë. Mund ta ilustrojmë këtë me shumë shembuj të marrë gjithandej nga familjet zadrimore në fshatra të ndryshëm. Për më shumë po i drejtohem historisë së fshatit tim, Kodhelit. Dikur, sipas gojëdhënave, por edhe sipas dokumentave autoktone nga studiues të ndryshëm, njëri prej të cilëve i nderueri dhe i përndritshmi Dom Gaspër Gurakuqi, Kodheli ishte një fshat mjaft i madh; sipas gojëdhënave me rreth treqind shtëpi që grupoheshin në tetë lagje; sipas Dom Gaspër Gurakuqit me pesë lagje dhe rreth tetëdhjetë e pesë shtëpi. Po e paraqes këtë shkrim këtu,

ashtu siç është marrë nga origjinali:

“Tregojnë këtu se Kodheli dikur ka kenë pesë lagje:

Pleshë, 53 shtëpi;

Perzhinë, 8 shtëpi; Xhulaj, 6 shtëpi; Kolëgjonej, 12

shtëpi; lagja e poshtër, 6 shtëpi.

Se sa mundet me kenë e vërtetë kjo statistikë nuk mund e dijmë, veç po rreshtojmë statistikat historike të Kodhelit:

Frang Bardhi (1641(Kodhelin e ven me Dajç, Koterr e Krythë, 72 shtëpi me 750 frymë.

Miscellanea Vescovile di Sappa (1832) e ven me 34 shtëpi, banorë 264.

Staistika e Austrisë (1917) e qet me 108 banorë. Asht e dijtun, gjithë=herë katolikë.

Nder statistikat e tjera ma të vona kishtare statistika e Kodhelit asht përfshi me statistikën e Famullisë së Nenshatit. Kodheli sot dahet në dy lagje: e sipërme e e poshtme.

Në lagje të sipërme janë 6 shtëpi një fisit, prej Kushnenit të Mirditës. Në lagjen e poshtme, dy shtëpi: e Gjokë Palokës e e Zekë Filipit janë prej Lurjet; katër shtëpi tjera: e Lazer Lecit, e Zekë Hilës, e Llesh Kolës e Frrokut patën të parë Zef Syqin, për të cilin thohet se Kodhelsit e kanë gjete foshnje e e kanë marrë m’e rritë. Prandej këtyne shtëpive të Syqit nuk u dihet fisi prej kah kanë ardhë. Ndermjet të dy lagjeve të Kodhelit asht shtëpia e Zef Markut, fis prej Oroshit. Fisi i Kushnenit tregon se i pari i tyne ka

pasë ngulë përmbi kishë.

Të Kodhelas, të dalun prej këtij katundi, ka edhe në Shkoder, nder të cilët Kel Kodheli, fotograf, të cilin e ka pasë marrë e ba bir në shpirt Pjter Marubbi, e prendaj Keli ka pasë marrë edhe mbiemnin Marubbi. Pozicjoni i Kodhelit asht kah lindja-jugu i Dajçit, larg kund gjysë orët prej këtij katundi. Kodhelsit kanë një natyrë të pagjët; e kanë disa anekdota të bukra. “(Don Gaspër Gurakuqi, Fiset e Veriut dhe Dioqezat”, Shtypshkronja Pakti, Tiranë, 2019, f. 102-103.

Ky shkrim autokton na jep mjaft fakte, jo vetëm për madhësinë e fshatit, por edhe prejardhjen e fiseve ekzistuese të Kodhelit të para njëqind viteve si dhe ata që kanë arritur deri në kohën e sotme. Është krejt e qartë se shumica e popullsisë së sotme të Kodhelit janë me origjinë mirditore. Po le të shtrojmë pyetjen: Cilës etni i përkasin kodhelësit e mi sot?

Të gjithë po t'i pyesësh një për një që nga më i moshuari dhe deri tek fëmija i shkollës (nuk po flas për ata që nuk e kanë konceptin Zadrinë e zadrinorë), të thonë se janë zadrinorë të pastër dhe se nuk janë e as ndjehen në asnjë pikëvështrim si mirditorë. Fisit tim ia kam bërë si dhuratë duke paraqitur si një testament të shkruar, se kemi një origjinë mirditore e kryesisht nga bajraku i Kushnenit (Kushndinit, siç e shqiptonin të parët tanë e siç shihet, shqiptimi ishte i Zadrinës si një nuancë gjuhësore e ngulitur në shekuj). Ndoshta është

me vend për ta sqaruar se nga vinte ai emër vendi. Si shumica e emrave vendesh, edhe emri Kushnen e ka një prejardhje që vjen nga togfjalëshi Kush Ndin? Në variantin e gjuhës së mirditorëve: Kush Nee? Si përfundim Kushneni në variantin autokton mirditor. Në variantin autokton zadrिमor Kushndi. Por, po t'i thuash secilit prej tyre që është mirditor, ta merr për një ofendim. Ky fakt, jo se është mendimi dhe gjykimi im i parapëlqyer, por se është fakt. Arsyet mund të jenë të shumta, pse nuk u vjen mirë t'i quash mirditorë, me të drejtë, ose pa të drejtë, po unë nuk po ndalem këtu t'i gjykoj ato arsye. Po qe për mua, kam gjykim tjetër dhe po e sqaroj, pasi më përket vetëm mua personalisht dhe jo pjesëtarëve të fisit tim. Personalisht, unë jam i bindur për etninë time zadrimore, por nuk ofendohem, po të më thonë mirditor, edhe pse nuk mund ta pranoj. E para është se unë kam respekt të veçantë për popullin e Mirditës, pasi në një nga zonat e saj shpenzova një pjesë mjaft të konsiderueshme të jetës sime duke jetuar e punuar atje ku gjeta nderim e respekt të veçantë të pastër dhe pa hile, formova mjaft shokë e miq që mbetën të paharruar për mua; gjeta mikpritjen e tyre bujare tek ata; gjeta miqësinë e gjyshit tim atje që më nderoi e respektoi falë asaj miqësie të vjetër; formova miqësi të re; kam shumë shokë nga më të mirët dhe më besnikët, jo vetëm të asaj zone mirditore ku jetova e punova, por edhe tek mirditorët e Zadrимës, nga fqinjët e mi të mëhershëm e të tashëm, ndaj opinionimi im për ta

është krejt i ndryshëm nga ai që thashë po t'u thuash kushërinjve të mi se janë mirditorë, pse origjinën e kanë nga Mirdita. Pra është ndryshe origjina e ndryshe etnia. Unë nuk e mohoj, madje, siç e thashë, edhe e kam deklaruar me një monografi të shkurtër origjinën time si dhe jam përpjekur të gjej rrënjët e mia atje. Po nuk mund të them se origjina ime mirditore ma jep e ma cakton etninë time. Pra, me etni jam i pastër nga Zadrima, pra zadrimor dhe me origjinë jam nga Mirdita e kjo nuk përbën një sens për mua.

Mora shembullin më të afërt me veten time e pastaj duke u hapur rrathë-rrathë si rrathët e ujit, mund të shtrihem tek fiset e tjera të Kodhelit, ashtu siç i pati shkruar Dom Gaspër Gurakuqi, janë edhe ata me origjinë nga Mirdita, të rënë në Zadrimë më parë, ose më pas se fisi im, që sot pothuajse zë gjysmën e fshatit si popullsi, dhe nuk e pranon asnjëri që është mirditor.

Kështu mund të themi edhe për Baqlin që ka një histori gati krejt të ndryshme nga fshatrat e tjerë të Zadrimës dhe disi të ngjashme me disa fshatra. Baqli kishte një popullsi tërësisht të besimit islam, ndërsa sot nuk gjen aty as edhe një familje, as edhe një person të besimit islam, pasi u shpërngulën të gjithë dhe vendin e tyre e zunë banorët e sotëm që janë të gjithë të etnisë zadrimore, ndryshe nga fenomeni Dragusha që patën të njëjtën histori, pothuajse, veçse baqlorët u ngulën aty më herët se dragushalinjtë.

Rrathët koncentrikë mund t'i shtrijmë më përtej se

Baqli dhe pikërisht tek Fishta, Krajni, Troshani, Kotrri e më tej. Thuhet se ishin fshatra me popullsi të besimit mysliman. Ndoshta Krajni, Fishta dhe Kotrri, po. Është një fakt dëshmues edhe mungesa e kishave dhe varrezave vetiake për këta fshatra, por jo sot, pasi sot edhe i kanë disa prej tyre, po para se diktatura i shembi ato objekte kulturi. Fishta, sot, edhe pse nuk është një fshat që të ketë banorë të besimit islamik, nuk e ka kishën e vet e as varrezën, sipas dijes sime. Kjo të paktën deri para vitit 1967. Ato i kishte së bashku me Troshanin. Krajni ka ngritur kishën e vet, ashtu si edhe Baqli që ka edhe varrezën e vet ngritur që në kohën e monizmit e tash edhe kishën.

Baqli para shembjes së objekteve të kultit i kishte varret dhe kishën edhe me Kodhelin, por edhe me Nënshatin, ashtu siç i kishte edhe Krajni me Nënshatin. Kotrri që kishte të përzier edhe popullsi të besimit fetar islamik, nuk pati as kishë e as varre të vetat, por i pati me Dajçin. Në dijen time, aty pati veç varrezë të fisit Zyberi, por jo për pjesën tjetër të fshatit. Dragusha, po ashtu, e ardhur vonë në ato troje, duke mos e pasur atë kohë e mundësi t'i krijonte kishë e varre personale, u mbështet tek fqinji i tij, Maba që e kishte edhe më afër.

Më sipër e cekëm pak edhe historinë e popullimit të vonë të fshatit Dragushë, madje, duhet të themi se ky popullim i vonë që filloi para një shekulli, aty nga viti 1920, ishte popullimi i tretë i atij vendbanimi. Për këtë, mjaft të dhëna qoftë duke u mbështetur në gojëdhëna,

qoftë duke iu drejtuar dokumentave historike të ndonjë studiuesi, banori i këtij fshati, Zef Mark Dragusha na sjell mjaft të dhëna interesante për këtë gjë dhe kështu po i sjell këtu disa fragmente të shkëputura nga libri i tij me titull: **“ÇFARË MBAJ MEND UNË PËR FSHATIN DRAGUSHË”**

Gojëdhënat thonë se Dragusha ka dalë fare (është shfarosur, është zhdukur) dy herë. Popullsia e parë e Dragushës nuk ka lënë dokumenta me vërtetue ardhjen as largimin e tyre prej këtij fshati, ose cilën fe kanë pasur. Është dëshmuar nga disa burra të vjetër, që familjet e tyre jetojnë në fshatin Mabë, të cilët kanë qenë fshatarë të fshatit Dragushë herën e dytë, se Dragusha herën e dytë thuhet se ka qenë me popullsi myslimane.

Ata pleq kanë deklaruar me gojë se prej popullsisë së parë të Dragushës kanë mbetur thjeshtë disa shenja, si: Ndërtimi i pusit të ujit të pijshëm, të burimit, Kroit të Dragushës dhe mendohet se i kanë dhënë dhe emrin që ka sot fshati, pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar fjala gjatë përdorimit deri në ditët e sotme.

Thuhet se kryeplaku i kësaj popullsie të herës së parë e ka pasë emrin Drago, një burrë i përmendur për dijeni, që ka rregulluar konflikte edhe në fshatra të tjera të Zadrimesë.

Aq shumë ishte i përmendur emri Drago, si pasojë e transformimit gjatë përdorimit, erdhi deri tek

fjala Dragushë dhe kështu i mbeti emri Dragushë fshatit ku ai jetoi me njerëzit e tij për një periudhë, të cilën nuk e dimë se sa ka zgjatur. Vetë nga emri Drago, sigurisht që, sipas mendimit tim apo të dikujt tjetër që mendon si unë, mund të jetë emër me prejardhje sllave, pasi janë shumë toponime me emra sllav, që janë bërë pjesë e toponimisë së shqipes, si Zadrimea etj.

Në grykën e pusit të Krojit të Dragushës të bërë nga popullsia e parë e këtij fshati, në vitin 1962, kemi bërë kabinën e ujit të pijshëm me çezme, që është edhe sot në vitin 2011.

Pusi ishte i bërë një metër larg me rrjedhën e lumit, 2 metra thellë ishte i bërë me gurë. Ujë i mirë, si ujë i bjeshkës, shumë i ftohtë për verë dhe i nxehtë për dimër, ka mbajtur gjallë gjithë atë periudhë popullsinë e këtij fshati dhe më tej. Edhe sot është i përmendur Kroji i Dragushës shumë më gjerë se hapsira e zonës së Zadrimës për vetë cilësitë e tij.

Në punimet që janë bërë për restaurimin e tij, kemi gjetur gjethe lisi. Sigurisht që kjo gjethe kishte ardhur nga bjeshkët. Por fakti është se në afërsi të Kroit të Dragushës, po të bëhen shpime kudo në një gjatësi të konsiderueshme, del ujë i njëjtë me atë të Kronit.

Në bisedë të lirë shoqërore me plakun 90 vjeçar të shtëpisë së Rrozhanit, në fshatin Mabë, Gjush Lok Rrozhani, i cili nuk jeton më, por që shquhej për kujtesë të mirë, më ka shpjeguar për prejardhjen e

emrit Dragushë si dhe për pusin e Kronit Dragushë, aq sa ai mbante mend siç ia kishin transmetuar të parët e tij. Emri i fshatit (Dragushë) dhe Kroji i Dragushës janë shenjat e lëna këtij fshati prej popullsisë së parë të larguar nga Dragusha.

Edhe unë isha shumë i interesuar, thjeshtë për me ditë diçka rreth të dhënave gojore për këtë fshat, me e ditë historinë e këtij fshati, pasi kisha ardhur që në vitin 1938, në moshën 8 vjeçare prej Mirdite, fshati Korthpulë, edhe u rrita e u plaka deri në moshën 66 vjeçare në këtë shoqëri të nderuar, pjesëtar i asaj që kam nderin t'i kujtoj ata si dhe vështirësitë e kohrave të kaluara në atë fshat, i cili sapo kishte filluar mbijetesën në kushte të vështira dhe pa asnjë lloj institucioni, për të cilët ka nevojë komuniteti në përgjithësi dhe vetë njeriu në veçanti, duke bërë të mundur një mbijetesë shumë të vështirë në kohra të ndryshme.

.....

Për të mos iu dorëzuar turkut dhe për të mos ndërrue fenë, dolën në zonat malore pa kushte dhe mjete jetese.

Në një studim të bërë nga historiani i nderuar i Lezhës, zotni Loro Gjeçi, i cili nuk jeton më, për Zadrimen, ndër të tjera shkruan: "Në vitin 1478, Zadrima me kryqendrën e saj Lezhën, ra nën sundimin osman. Lezha u dogj dhe u rrafshua, kurse popullsia e qytetit dhe e fshatit braktisen trojet, duke emigruar

jashtë atdheut, ose morën malet për të mos rënë në dorë të turkut. Me pushtimin turk e gjithë Zadrima u shpall Vakuf (pronë perandorake). Popullsia u ngarkua me më shumë tatime e taksa se sa prodhonte."

.....

Në studimin e historianit Loro Gjeçi, për fshatin Dragushë sillet dhe një fakt i veçantë, të cilin nuk e kisha dëgjuar, por, pasi e lexova, mendova ta shënoj si e veçantë.

"Dom Pjeter Mileti (1840) që i fisit të lagjes Miletaj në Dragushë. Në Dragushë nuk ka mbetur kurr një banorë i hershëm... Ka pasë dhe famullitarë të tjerë me mbiemër Mileti, të cilat i kam zbuluar në arkivat e Famullisë së Kodhelit dhe të Dajçit. Miletët kanë mbajtur dhe mbiemrin Dragusha. Mbiemri Mileti rrjedh prej Mbi Lete. Në kufi me Dragushë është Dhe i Letë, që ka në rreth të vet sinjorin Lete..."

Në vitin 1990, në kohën kur është bërë ky studim nga z. Loro Gjeçi, Dragusha kishte në total 413 banorë, prej të cilëve 202 meshkuj dhe 211 femra.

Diçka për varret e dragushalinjve

Katolikët i kanë pasë varret tek kisha e vjetër në Mabë. Shuma e dragushalinjve myslimanë e katolikë janë larguar nga Dragusha e kanë dalë në Mabë me ju afrue zonës së Barbullushit për të pasur dalje drejt qyteteve Shkodër e Lezhë, edhe katolikët e Dragushës

janë afruar rrugës, kishës edhe varreve, iu larguan rrugës së keqe kodrinore e kalimit nëpër moçale Mabë - Dragushë. Nga këto vështirësi, sipas gojëdhënave, janë larguar pjesa më e madhe e Dragushës për në fshatin Mabë.

.....

Katolikët, varrezat i bëjnë në vendin e bekuar nga prifti, të gjithë fshati të bashkuar.

Myslimanët i bëjnë sipas dëshirës familjare nëpër pronat e veta, zakonisht pranë shtëpive të tyre. Kjo gjë është dhe një shtysë tjetër për të më bërë mua që të besoj për një fakt që popullsia myslimane e Dragushës, e cila, siç e theksuam, ka banuar në këtë fshat, sipas mendimit dhe bindjes sime, një pjesë e tyre i kanë pasur varrezat poshtë shtëpisë të Nikoll Ded Brungës, afër kanalit të madh kullues që bie në lumin e vogël, i cili kalon në zonën verilindore të fshatit Dragushë dhe derdhet në Gjadër e që quhet Glinë.

E them me bindjen time personale, sepse, me rastin e hapjes së një vije vaditëse afër kanalit kullues në kohën e Kooperativës Bujqësore, kemi nxjerrë shumë kocka njerëzish deri në fundin e vijës që lidhet me arën e Nikoll Shkurtit. Kur mata punën e bërë nga punëtorët e brigadës së Dragushës, sepse isha brigadier në atë periudhë, nuk gjeta asnjë metër vend pa kocka njerëzish nëpër varrezat e tyre rresht. Këtë ma deklaruan dhe të gjithë punonjësit e brigadës para se ta shikoja vetë, duke shprehur një lloj habie për këtë

gjë. Kjo më bindi se në Dragushë kanë jetue shumë popullsi myslimane.

Por ky është mendimi im dhe i personave me të cilët kam punuar në atë periudhë dhe nuk mund të them se një gjë e tillë është absolute, sepse aty mund të bëhen studime në të ardhmen dhe mund të dalë një mundësi apo fakt tjetër, ndryshe nga ajo që mendoj unë, sepse Shqipëria është pëllëmbë e histori. Por i rëndësishëm është fakti që unë e kam parë një skenë të tillë. Dhe jo vetëm unë, por i gjithë populli i Dragushës në atë periudhë.

Çfarë kam dëgjuar unë se si u largua popullsia e Dragushës herën e dytë

Siç thuhet dhe kam dëgjuar unë, pjesa e mbetur nga myslimanët herën e dytë në Dragushë janë larguar familjarisht nga ky fshat nga Lufta e Parë Botërore.

.....

Në vitin 1920 erdhi shtëpia e parë e Ndrec Lazër Gjinit nga Korthpula e Mirditës me 5 djem në Dragushë, fisi Gjopalaj, të cilët më përkasin mua. Ato blenë tokën edhe bënë shtëpitë pa lejen e Paçramit, i cili e konsideronte këtë zonë si të tyren pasi nuk kishte asnjë banorë në Dragushë në këtë periudhë.

Sa e morën lajmin Paçrami, siç tregonte Zef Ndrec Lazri, i cili ka vite që nuk jeton, u përgatitën 10 burra të armatosur, erdhen dhe i kërkuan Ndrec Lazrit

të largohet nga Dragusha pa vonesë ose do të zhdukim me të gjithë njerëzit që ke.

Ndrec Lazri, me qetësinë më të madhe, u kishte dhënë këtë përgjigje:

-Nuk kanë le ato burra që më largojnë prej Dragushë. Unë kam ardhur këtu me jetue dhe jo me luftue me njeri. Prandaj na lini të qetë në hallin tonë se nuk jemi në trojet tuaja.

Dëgjuan këto fjalë të ashpra 5 djemtë e Ndrecës dhe menjëherë u përgatiten me luftue për të mbrojtur truallin mbi të cilin kishin vendosur të jetonin, të armatosur, dhe ju përgjigjen:

-Nëse doni me shkue të gjallë në Paçram, largohuni! Kjo punë ka marrë fund. Jemi të përgatitur edhe 50 burra po të jenë, një i gjallë nuk shkon në Paçram.

Ky dialog pak i ashpër nga të dy palët, krijoi një situatë të vështirë për paçaramsit, të cilët u shtruan në bisedë më të qetë. Atëhere mësuan se tokën e paskan blerë këto mirditorët, se ato nuk e kishin ditë këtë gjë dhe ranë dakort që ata të vazhdonin të jetonin në këtë fshat. Dhe vërtetë jetuan në një marrëdhënie shumë të mirë gjatë të gjithë kohës, duke krijuar edhe lidhje kumbarie me njëri-tjetrin, pavarësisht besimeve fetare të ndryshme. Kjo miqësi ruhet edhe sot nga disa familje, sepse edhe nga Paçarami kanë ikur të gjithë ata që banonin në atë kohë dhe fshati është populluar me të rinj të ardhur nga zona të ndryshme të vendit.

Paçramasit ishin burrra trima, por edhe burra të mençur, shumë bujar, të dashur dhe shumë punëtorë.

Në këto situata dhe nga nevoja për të qenë më i sigurtë në një vend të ri, siç ishte ky fshat ku kishin ardhur të jetonin, familja e Ndrec Lazër Gjinit mendoj me sjellë në fshatin e ri njerëz të afërm të tyre të ardhur nga Mirdita. Kjo ishte edhe si një refleksion i kohës për të qenë të bashkuar dhe të mbrojtur nga çdo kërcënim.

Në vitin 1922 erdhën në Dragushë Lazër Kol Kqira, shtëpi e madhe, familje e nderuar në Mirditë.

Në vitin 1929 erdhi edhe familja e Prend Kovaçit, edhe kjo familje e madhe, me emër të mirë dhe e nderuar në Mirditë.

Këto 3 shtëpi të mëdha e të përmendura në Mirditë, nga të gjitha pikëpamjet, me burra të besës dhe trima dhe shumë të lidhura nga ana fisnore, kumbari, u bënë mbështetës të njëri-tjetrit dhe mbajtën peshën e të gjithë fshatit. Në vazhdimësi sollën dhe fise të tjera, secila me emër të mirë dhe familje të respektuara.

....Dragusha ka qëndruar 27 vjet nën vulën e fshatit Mabë, si një lagje e saj. Në mungesë të kishës e varreve, jemi detyruar 80 vjet me i krye shërbimet fetare e funerale në Mabë.

I solla disi edhe me hollësi këto fragmente nga libri i Zef Dragushës, ashtu siç i ka paraqitur aty, me qëllim që të krijohen idetë e qarta për të ditur si janë krijuar

disa popullime të vona në Zadrimë dhe arsyet e ruajtjes së zakoneve dhe traditave të tyre.

Nga sa pamë e paraqitëm edhe më sipër, çdo fshat i Zadrimës ka histori të veçantë dhe gati të ndryshme nga njëri-tjetri, ndaj nuk është për t'u çuditur shprehja popullore që qarkullonte dikur: “Katund e pidat, shpi e znat!”. Me pidat, fjalë turke e futur në fjalorin popullor, nënkuptojmë ngjarje e tradita karakteristike për një fshat, ndërsa zanat mund të themi se secila familje pati specialitete të ndryshme profesionale, dikush kishte zanat punimin e metaleve, dikush bluarjen e drithërave të bukës, dikush punimin e drurit, dikush punimin e gurit e ndërtimin, dikush pati traditë mbarështimin e gjedhit, dikush të dhenëve, dikush të dhive, dikush bletët e dikush shpendtë e llojeve të ndryshme, pata, rosa, gjela deti, pula, etj. Pra edhe këto përbëjnë ato që ne i quajmë tradita të një etnie të caktuar, megjithse nuk janë përcaktuese.

Ato tipare që janë më shumë përcaktuese për termin etni, janë më shumë zakonet e njësura për një popull të një zone a krahine të caktuar. Kështu, zakonet e traditave të Zadrimës ndryshojnë shumë me ato të Mirditës dhe të etnive të tjera, brenda dhe jashtë saj. Ato lidhen sidomos me ritet e ndryshme të jetës siç janë ato të martesave, lindjeve e vdekjeve. Dasmat në Zadrimë janë zhvilluar krejt ndryshe nga dasmat në të tjera krahina e etni krahinore. Gjithmonë ka ekzistuar shprehja: “Si asht vendi, bahet kuvendi!”, prandaj në

Zadrimë dasmat kanë pasur elemente që Mirdita, por edhe Kallmeti e krahina të tjera etnike nuk i kanë pasur e kjo ka arritur falë kushteve shoqërore. Në Zadrimë nuk janë rreshtuar miqtë e ftuar në dasëm sipas bajrakut, por sipas miqësisë, pasi Zadrimea nuk ka funksionuar si organizim shoqëror e politik sipas bajraqeve, madje, nuk i ka njohur fare ato, veç si një kujtim i largët që nuk ka asnjë lidhje të qenësishme me të. Në krye të vendit është respektuar gjithmonë daja i fëmijës që po martohej dhe jo ndokush tjetër. Në Mirditë, në krye të vendit, në dasmën e djalit qëndron krushkamadhi e pas tij vjen daja i djalit. Kjo ka ndodhur në monizëm, se në kohët e para monizmit, rreshtoheshin sipas bajraqeve ku vendin e parë e zinte Oroshi si bajrak e me radhë, Spaç e Kushnen, etj.

Zadrimorët, kur kanë shkuar të marrin nuse, kanë shkuar një numër mjaft i madh krushqish, gjithnjë të përzgjedhur nga i zoti i shtëpisë dhe janë nisur në ditën që do të merrej nusja, në mëngjes, duke llogaritur mirë kohën që u duhej ta përshkonin rrugën gjer tek shtëpia e mikut (nuses), qëndrimin atje dhe kthimin në kohë, gjithnjë në, ose pak para vakthit të shtrimit të drekës. Mirditorët e caktonin numrin e krushqëve së bashku me mikun, një numër të kufizuar, shtatë, nëntë, apo më shumë se atë, por jo ta kalonin numrin trembëdhjetë dhe niseshin që një ditë para se ta merrnin nusen, pse do të flinin në shtëpinë e mikut duke pritur t'u bënin lloj-lloj rrengjesh e të papriturash që duhej të ruheshin,

se do të turpëroheshin. Kjo ka ndodhur, pse miqësia si zakonisht, e lidhur nga shkuesi të ndryshme, ishte mjaft e largët dhe rruga shumë e gjatë. Zadrima i pati krijuar lidhjet martesore brendapërbrenda saj dhe jo shumë larg nga fshati në fshat, kështu që nuk e kishte të nevojshme ta ruante më këtë zakon.

Për zadrimorin miku ishte i shenjtë dhe të gjithë të barabartë mes tyre, si i pari, ashtu edhe i fundit dhe nuk lejonte askënd të ngacmonte me fjalë e ofendime të tjerët. Ata që i krijonin këto gjeste të papëlqyeshme, nuk ishin të mirëpritur dhe u tregohej dera, kushdo që të ishte, daja, axha, nipi, kumbara a kushdo tjetër. Në Mirditë e quajnë për zotësi e zgjuarsi të ngacmoh të tjerët me fjalë e ofendime dhe e lejojnë të ndodhë.

Dasma në Zadrinë ka filluar përgjithësisht dy javë para se të merrej nusja e cila si zakonisht është marrë ditën e hënë. Dy javë para, në kishën e fshatit ku bëhej dasma, e djalit ose edhe e vajzës, bëhej leçia, lajmërimi i asaj martese që njerëzit ta kishin mundësinë të flisnin për ndonjë gjë që ishte në kundërshtim me atë martesë, ose të heshtnin. Atë ditë shtrohej edhe dreka me një rreth të ngushtë miqsh e të afërmish e fillonte kënga. Ditën e enjte për djalin dhe ditën e premte për vajzën, mbledhej fisi në shtëpinë e atij që bënte dasëm, jepeshin detyra për secilin dhe shpërndaheshin thirrësat për të njoftuar miqtë e ftuar në atë dasëm. Fisi ishte një njesi perfekte për këto raste dhe askush nuk e kundërshtonte detyrën e ngarkuar, por secili e kryente

me përpikmëri. Në Mirditë, do t'i duhej babait, apo vëllait e xhaxhait të djalit, ose vajzës që martohej që të shkonte nga miku në mik për ta ftuar që nga çasti që ndahej dita e dasmës e deri kur të arrinte t'i njoftonte të gjithë e kjo jo veç me ditë e javë më përpara, por edhe me disa muaj para ditës së dasmës.

Këtu solla veç dallimet në traditat e organizimit të dasmave, por ndryshime të dukshme ka edhe për ritet që bëheshin me lindjen e fëmijëve. Në Zadrimë, kur lindte një fëmijë, nëna e gruas lehonë (asaj që lindte fëmijën) caktonte një ditë kur do të mbledheshin gratë e të dyja gjinive (nga krahu i gruas dhe nga krahu i burrit siç mund të ishin motrat, hallat, tezat e me radhë) për të shkuar e për ta përgëzuar e uruar nënën lehonë dhe fëmijën e lindur duke iu dhuruar peshqeshe të llojeve të ndryshme, si nënës, ashtu edhe fëmijës. Siç e theksova, dita kur do të shkonin atje për pasim, kështu quhej ai rit, caktohej nga nëna e gruas lehonë dhe asnjëherë nga vjehrra (nëna e babait të fëmijës së lindur), ose nga vetë lehona. Krushka, (nëna e lehonës), në këtë rast kishte një peshë të veçantë dhe duhej të merrte kohën e saj të nevojshme, pse duhej përgatitur me peshqeshe që ishin të kushtueshme dhe donin kohë për t'i siguruar ato. Nuk e kam dëgjuar se ekziston ky zakon në Mirditë. Atje shkojnë për urime në kohë të ndryshme dhe jo të organizuar në një ditë të caktuar si në Zadrimë. Krahas peshqesheve për fëmijën dhe për nënën, pasoret e kanë zakon të çojnë petulla dhe një

shishe me raki, kurse pala pritëse, pasi mbaron dreka, i përcjell duke u dhënë seciles prej pasoreve kuleç të cilët i gatuanin me një stil krejt të veçantë.

Edhe zakonet e tjera dhe traditat që lidhen me raste të tjera jetësore kanë pasur diferencat dhe ndryshimet e tjara, por nuk po ndalem këtu t'i përmend e analizoj me radhë. Këtu dua të paraqes vetëm ato veçori që janë më pikante dhe që bëjnë dallimin mes njëres etni krahinore me tjetrën. Ato janë të shumta, por këtu më poshtë po paraqes një traditë të Zadrimes që dikur pati marrë zë mjaft edhe jashtë saj. Kjo traditë lidhet sidomos me atë mënyrë jetese të të ushqyerit dhe organizimit të tij nga amvisat zadrimore.

Kulinaria pothuajse nuk kishte shumë ndryshime, por Zadrima ka qenë përmendur në mënyrë të veçantë për bukën e qethit që kishte mjaft emër e famë. Për ta gatuar atë, duheshin siguruar disa kushte elementare të domosdoshme. Së pari, çdo familje zadrimore duhej të kishte furrën e pjekjës së bukës të cilën e ndërtonte në kushte artizanale, në ambiente të mbyllura në ndonjë jerevi a kasolle ose në ambiente të jashtme në mungesë të ndonjë mundësie të tillë.



Në këtë foto paraqitet një grua zadrimore që po bën gati furrën e bukës për të pjekur aty bukën apo lakrorë për familjen e saj. Siç duket, ajo furrë është ndërtuar në ambiente të jashtme, në mungesë të një mundësie për ta pasur në ambiente të mbyllura. Duke u nisur nga ajo që shihet aty, për nga struktura e ndërtimit të një furre buke të tillë, duhej edhe një mjeshtëri e veçantë për ta pasur sa më efikase atë furrë. Fjala këtu nuk ishte për nga bukuria apo paraqitja, por nga materialet me të cilat ndërtohej furra, krijimi i hapësirës së brendshme, jo vetëm në përmasa, por edhe në formë.

Për ngritjen e një furre, së pari ndërtohej me gurë një bazament i domosdoshëm dhe më pas shtrohej me tulla e deltinë (baltë e veçantë dheu), pastaj fillonte e ngrihej kubëja, edhe kjo me copa tjegullash e deltine e

pas saj vishej me mure guri që të mos e dëmtonin shirat apo erërat e ftohta, pasi do të ndikonin pastaj që buka do të dilte prej asaj furre me një cilësi të dobët. Tullat e tjegullat ishin të domosdoshme për ndërtimin e një furre, pasi ishin ruajtës të nxehtësisë më shumë se guri. Po kështu edhe deltina që ishte baltë dheu e veçantë dhe e zgjedhur, kur thahej, bëhej një masë unike prej qeramike dhe, përveç ruajtjes së nxehtësisë, kishte edhe vlerat e mbajtjes pastër dhe të shëndetshme të atij mjedisi.

Edhe zënia e brumit e gatuarja e bukës kishte artin e traditën e vet në këtë pjesë. Me ujë të valë zihej brumi i cili ngjishej shumë për një kohë mjaft të gjatë, pastaj hapej në qethë që kishte një formë rrethore mjaft të madhe, aq sa mund ta zinte lirisht gryka e furrës. Po me anën e qethit, pasi furra ishte skuqur mjaftueshëm dhe i ishte hequr flaka për të mos e djegur pa e pjekur e të mos i shkaktonte tymosje bukës, futej në furrë dhe lihej në kohën e mjaftueshme për pjekje perfekte. Në zonat e krahinat e tjera dhe nuk po cilësoj këtu veç Mirditën, buka piqej në saç edhe në votrën e shtëpisë apo në oxhakun që shërbente për ngrohje të njerëzve në kohë të ftohta dimri.

Pra, siç shihet, zakonet dhe traditat e zadrिमorëve ndryshojnë mjaft dukshëm me traditat e zakonët e të tjera etnive përreth Zadrимës dhe këto janë elemente që bëjnë dallimin mes tyre, por edhe përcaktojnë saktë e qartë se cilës etni i përket njëra familje e tjetra. Si këto

elemente përcaktuese kemi renditur edhe gjuhën si dhe veshjet tradicionale. Përsa u përket veshjeve, aty më sipër solla disa foto që tregojnë konkretisht dallimin mes etnive, ndërsa për gjuhën, që pa diskutim ka mjaft elemente të qenësishme dalluese në mes etnive, edhe pse nuk është elementi kusht dhe kryesor, ka pasur e ka mjaft elemente dalluese mes etnive të Zadrimes. Si shembull kam sjellë këtu nënën time që ishte kallmetore, por u martua në Zadrime dhe që nga ai çast e deri sa vdiq, i zbatoi me përpikmëri traditat e zakonet zadrimore e jo kallmetore, por theksin e gjuhën e vendlidjes së saj nuk e ndryshoi deri në vdekjen e saj. Ndoshta ky dhe disa raste si ky që kam njohur, kanë qenë raste anësore dhe të veçuara, por ishin mjaft domethënëse.

Gjithsesi, kriteri gjuhë ka qenë një kriter dallues mjaft i qenësishëm mes zadrimoreve dhe etnive të tjera. Këtë fakt e kam cilësuar edhe tek shkrimet e tjera, por këtu, duke mos dashur ta përsëris veten time para lexuesit të këtij shkrimi, dua të nënvizoj se edhe ky kriter sot, nën ndikimin shumë të fuqishëm të shkollës shqiptare të sotme si dhe shkollimit masiv të masave të popullatës shqiptare, ka bërë që të zbuten jashtzakonisht shumë dallimet, jo vetëm mes grupeve etnike të Zadrimes, jo vetëm mes krahinave të Veriut ndërmjet tyre, por edhe mes dy dialekteve të shqipes së sotme. Këtë gjë e bëri detyrimi i zbatimit të normës së njësuar letrare nëpër shkolla kudo në Shqipëri.

Nuk mund ta themi se ishte e pavend shprehja që disa zëra, sidomos jugore e thoshin “nuk e lexojmë Fishtë, se nuk ia kuptojmë gjuhën”, pasi, në të vërtetë, duhet thënë se, jo me rrjedhshmëri siç lexohen librat e tjerë të shkruar me normat e gjuhës së sotme letrare, mund të lexohen librat e Gjergj Fishtës sot, madje, do të thosha, as nga vetë zadrimerët, lë pastaj nga jugorët. Në fakt, librat e Gjergj Fishtës janë shkruar në gjuhën e pastër që Zadrime e zadrimerët flisnin para 100 viteve e deri mjaft vonë, koha kur Ai i kishte shkruar ato dhe as më pak e as më shumë ishin më të pakuptueshme se shkrimet e Ndre Mjedës, Pashko Vasës, Filip Shirokës, por edhe më vonë të Migjenit e Qemal Stafës, në ato pak shkrime që patën për kohën që jetuan. Problemi qëndroi këtu, se atyre, duke mos pasur “njolla në biografi” u ishte hapur porta drejt teksteve shkollore e dritës së botimit në monizëm dhe të madhit At Gjergj Fishta i ishte mbyllur me dryna çeliku të pahapshme. Edhe atyre të tjerëve, para se t'u hapej ajo portë, iu sitën dhe iu kreh dukshëm gjuha e teksteve të tyre.

Po. Gjuha ka evoluar nga koha në kohë edhe para periudhave të arsimimit masiv të popullsisë shqiptare e këtë mund ta tregojmë edhe nëpërmjet krahasimeve të veçanta. Për këdo ka qenë dhe është mjaft e vështirë të lexoheshin librat e Frang Bardhit, Pjetër Budit, Pjetër Bogdanit, e aq më shumë “Meshari” i Gjon Buzukut, jo për arsye të alfabetit të ndryshëm nga ai që sot përdoret e as ngase mund t'i përkisnin veç dialektit të Gegërisë e

jo Toskërisë, por se gjuha e përdorur aty, ishte pak më ndryshe nga gjuha e vetë Pashko Vasës e pak më vonë edhe e Mjedës, Fishtës, Prendushit, Nikajt, Shirokës, aq më tepër e të gjithë kohës së sotme. Por, megjithatë, nuk ishte më e pakuptueshme se e bejtexhinjve të asaj kohe Hasan Zyko Kamberit, apo e Nazim Bej Frakullës e pak më vonë e Kristoforidhit, Naimit, Çajupit, Asdrenit, etj., e ata kishin zënë vende kryesore në libra e tekste shkollore përgjatë regjimit komunist.

Jugorët kishin njëfarë të drejte kur thoshin se nuk i kuptojnë librat e Fishtës, kur i lexojnë, pasi gjuha që sot mësohet nëpër shkollat shqipe, gjuha e normësuar sipas Kongresit Drejtshkrimor të nëntorit 1972, u vendos si bazë gjuha që kishin përdorur në shkrimet e tyre Naim Beu, Andon Efendiu dhe shokët Shefqet, Ismail e Dritëro dhe jo ajo gjuhë që patën përdorur Budi, Bogdani, Bardhi, Zarishi, Vinçens Prendushi, Justin Rrota, Filip Shiroka, Pashko Vaso, Gjergj Fishta, Ndoc Nikaj, Ndre Mjeda, Zef Jubani etj. Jugorët e patën këtë fat edhe për faktin se në krye të shtetit monist ishte një kastë me origjinë jugore dhe si gjithmonë që “Ligjin e bën Maliqi”, edhe atëherë ligji u bë prej asaj kupole maliqiane dhe sot gëzojmë atë normë letrare e standard gjuhësor që kemi dhe jo shkodranishten e bukur letrare të vendosur që në vitin 1916 nga Komisija Letrare e Shkodrës.

Me gjithë këtë evulim gjuhësor, përsëri sot aty-këtu vërehen dallime të vogla gjuhësore mes grupeve etnike

e kjo si pasojë e një kulture mjaft të ngulitur që herët. Zadrivorët nuk e kanë të vështirë t'i shqiptojnë të gjithë tingujt e përdorimit të gjuhës shqipe, kurse disa prej grupeve të tjera etnike nuk mundën t'i shqiptojnë të gjitha. Jo vetëm që ngatërrohen në shqiptimin e “q” me “ç”, por në përdorimin e “y” janë fare të kufizuar, sidomos mirditorët dhe kallmetorët. Kështu, fjalët: çaj; çakall; çakçirë; çal; çalaman; çanak; çantë; çarçaf; çati; çekiç; çel; çelës; çelik; çerdhe; çetë; çoban; çorap; çun; etj., këto dy grupe etnike të Zadrivës e po ashtu të origjinës së tyre, i shqiptojnë: qaj; qakall; qakçirë; qal; qalaman; qanak; qantë; qarçaf; qatei; qakeiq; qel; qelës; qeleik; qerdhe; qetë; qoban; qarap; qun; etj. Këtu nuk po futem në detaje të tjera, pasi ka plot dallime e ndoshta jo kaq të theksuara në brezat e rinj e sidomos të shkolluar pas, sidomos në të shkruar janë mjaft të kujdesshëm dhe pak ngjasin këto dallime, por në të folurën e përditshëm janë më të theksuar.

Megjithatë, jo në pak raste vërehen edhe përdorime gjuhësore të theksuar tradicionale etnike edhe në të shkruar. Për këtë po sjell veç disa raste të shkëputura që përdorues të ndryshëm të rrjetit social Facebook nëpër statuset e tyre i përdorin nuancat gjuhësore karakteristike për atë grup etnik që i përkasin. Për arsye etike nuk o i cilësoj me emra konkretë autorët e këtyre frazave, por po i paraqes veç si shembuj ilustrimi:

Edhe une e kame njohe petritin nga zadrime i cili ka qane denu 25 vjet po me ardhjen e demokracis doli (shkruar nga një person me origjinë mirditore)
Me përjashtim siq hidhnin diversantë shqiptarë në kohën e Socializmit që lanë kockat në malet shqiptare.
Festofshi edhe 100 vite te lumtura ne vijimsi familjarisht e gjith qa keni per zemer
....shum falemnerit i pac me jete e Zoti u ruajte familiarisht....

....Të kyqurat gojë do të qelë,....

....Dhe qau njësoj si Ujtmani kur qeli jargovani.

...., heqjes apo shtimit, ashtu siq kane mbetur percjellin gjithnje freskine e shijeve te at'hershme

....Ti që e ke idhullin tan, madje pa ja thanë....

....Po ku ta qojmë zemren ?

Qifteli: Ervin Gega

....bravo te qoft ty per promovimin e vlerave te pa qmueshme qe i ka mirdita jon e bukur,singerisht qdo mirditor te esht borgjli ty...

Pershendetje nga Londra (prej Bisakut T'venit !

Të knoftë zemra Artist

Nuk ka kun si Mirdita jone.....

Krenare se jam mirditore,te knoft zemra gjin

Zemra te knofte o aristi i madh mirditor ju lumshin kembet gjithve

Te knoft zemra nga nipi

Te knofte zemra

te knoft zemra

Edhe me beri **qudi** vendosja sepse ishte vajza e 3 me te blu dhe vajza e 4 me te zeza...

....për fisnikrinë e tyne të gjakut dhe virtytit të fesë, si dhe për **senet** e shejta dhe nierzore janë të deja për lavdrim".

.... i ka shkruar te gjitha athere edhe **qa** do na gjente sot.

Qeqen e shpellare

Do i punsojme si druvarë.(mird.)

Pushofshin ne paqe e ju **paqi** shendet e jet e ti . (mir.)

Njëri nga murgjit nga kurioziteti shkon deri tek një vend i quajtur "**Gjurth**" për të parë se çfarë kishte ndodhur. (toponim mird.)

... u jam secilit **borgjëli** që ua shperblefsha veç në gezime; (mird.)

Borgjëli sa të kem frymë ndaj secilit prej jush!

2 **Nanor**, T'Shumat. (mird.)

....u botua ne nje vit te **quditshem**, me 1997....(mird.)

Siç shihet, në ato shembuj që solla aty më sipër, përveç traditës së përdorimit gjuhësor të një tingulli në vend të një tjetri si **q** për **ç** dhe **gj** për **xh**, pjesa më e madhe e atyre përdoruesve, manifestojnë mjaft gabime të tjera drejtshkrimore, çka i afron më afër origjinës së tyre si etni. Të tjerët veç për traditë të ngulitur, sidomos tek ai që përdor fjalën "borgj" për "borxh", që nuk vjen prej pamundësisë së përdorimit të mjetit me të cilin shkruan për t'i shkruar ato shkronja si **ç**. Ka plot të tjerë që nuk e dinë teknikën e paraqitjes së kësaj shkronje, por për këtë përdorin shkronjën **c** për ta nënkuptuar **ç**.

Karakteristika e të folmës së etnisë mirditore janë edhe mospërdorimi i shkronjës **d** në grupin **nd** dhe aty kam sjellë mjaft shembuj, sidomos nga disa komente që i bëhen në formë urimi njërit prej këngëtarëve mjaft të përmendur nga Mirdita në kohën e sotme. Ka edhe plot shembuj të ndryshëm të cilët mund t'i sillja këtu, por mendoj se këto janë të mjaftueshëm sa për ta krijuar idenë e ndryshimit gjuhësor mes këtyre dy grupeve etnike që jetojnë të ndarë si dhe në gji të njëritjetrit: zadrimorë-mirditorë. Aty, disa nga shkrimet nuk i kam paraqitur të plota, madje edhe i kam shkurtuar, pasi ishte qëllimi të jepet ideja dhe jo kritika ndaj atyre që i kanë shkruar ato statuse apo komente.

Në analogji me këto shkrime statusesh, kam shkëputur fare pak shembuj nga statutet e përdoruesve me etni të grupit zadrimor e po i jap disa prej tyre këtu më poshtë: *Paçin driten e pambarume dhe pushoshin ne paqe!*

(zadr.)

Paçin Dritë! Pushofshin në Paqe! (zadr.)

Paçin dritë ,e pushoshin në paqe..!!(zadr.), janë disa komente të një statusi të paraqitur me rastin e Ditës së Të Shumëve me datën 1 Nëntor.

Më poshtë po jap edhe një shkrim tjetër krejt të veçantë që paraqet një nuancë gjuhësore zadrimore që ka ardhur që nga kohët e vjetra dhe deri në ditët e sotme:

*E n'shkreti sa **kjetë** banorë,...*

*...Kshtu **qi** t'gjithë n'**nji** vathë le t'kapen* (zadrimore)

Le t'i analizojmë këto raste:

Në shumë fjalë, grupi i bashkëtingëlloreve **kj** për **q** në Zadrimë përdoret mjaft dendur dhe kryesisht në fjalën e mësipërme si dhe fjalët: qaj-kjaj; qartë-kjartë; kje-qe; qur-kjur; qumësht-kjumësht; etj., dhe si këto raste kemi edhe fjalën kjukë për klluçkë, apo kllukë.

Fjalët e tjera të nënvizuara më sipër, flasin për një përdorim të **i** në vend të **ë**. Mund të sillnim mjaft raste përdorimi të tillë, por po mjaftohemi me kaq.

Nuancat malësore i kemi tek këto shembuj:

Lash një qiri **t'nezun** e një pijate me t'ambila ...

E shkova me ra si tash e para dymije vjete tue **mendua**
Se keni me kthye naten e pa dashte kand me **trishtua**
(mal.)

*“Pasuninë, a?! Për pasuninë teme, mos u mërzitë se e kam **sigurua!**”*

*...“Ograjat m'i ka marrë ushtria, e janë tu i **rrethua** me bunkera-as zogjtë e malit s'kanë me mujtë me hy ma n 'to e, edhe ty s'kam me t'**ranua** ma me ardhë me m'**ndihmua** as me thure e as me **rregullua** muret e tyne.”*

*“E njato toka kush asht tu t'i **punua?**” vazhdon Gjergji si me shpoti.*

“Për token - pash t'madhin Zote, çka je tu m'dvet për tokën! Këta kjoftlargtit e kanë marrë e janë tu e mbjelle me bërðhok e tallë...”

*“Pra, si te thashë, edhe si po e sheh ti vet, pasuninë e gjanë e gjalle e kam **sigurua**, o **Kelmenas** i*

jem."...".k'ta komunistat e vllaznuem me shkije, edhe s'po na lanë me dalë ma me verua n'Vermoshë, n'bjeshk e vend tonë, Luvigjin, fortë asht tu ma mundua një e ftohme në mushkni, besa..."tha Marku dhe tue lëviz sa pak trupin, për me rregullua ndejen e tij këmbëkryq, vuni çibukun ne gojë, thithi në te nja dy tre here dhe tu lëshua për rreth rrathë tymit, vazhdoi: ...

Në atë moment, pa e vu re, gjehen përballë urës se Bunës. Dy ushtarë rrinin ne shteg te saj me pushkë ne dorë dhe kontrollonin çdo kand që donte me shkua për Shiroke a Muriqan.

"Po, a s'janë largua prej shqipniet ala këta?", tha Lezja, tue shikua andej nga ura.

...tha Martini, tue ia hell krahun rreth qafës së saj e tue rroke për veten ne ecje.

Kumbonte e Kishës se Zojes ranë tue lajmënua se ora po shkonte tre e mbasditës.

Marrin nga një qiri dhe e ndezin dhe e vendosin ne njarën ane te altarit ne mbajtësen e qirave dhe zane vende ne një ndenjësë.

"E gjallë po jeme...si me dashtë me jetua për me provua te tana mundimet e k'ti shekulli - thua se kem gjuejt Kishën pesha, o Gjergj Marashi!"

"Gjuejt Kishën pesha jo, por edhe m'e ruejt mos m'e rrënua s'mujtem", tha Gjergji.

"Një mije e ma shume vjet ajo Kish e Shenkolli në Kakarriq, me derë hapun tu pritë e përcjell, tu

pagëzua e shëlbua lindjen e vdekje, tu pajtua gjaqe e tu bekua jetën e gjindes! Edhe Turk e Shkja erdhën e shkuen, na prenë e dogjën, por n'atë Shpi t 'Zotit s'vunë dorë! E na, mbasi nja dy a tre vendali e katunas na i lidhën sytë me rubat e kuqërreme te shkinave, ramë n 'gjumë atë natë, e ja vunë dinamitin dhe e hollën ne erë, Kishën!”, tha Marku, tue këqyrë Gjergjin në kokërr te syve, e rrahu gjunjët tue rrezua pëllëmbët e duerve të tij mbi ta.

....,po ajo semundje e madhkuar te lodhi ,te gjithë thame se ja holle po semundja gjithmone e pabese....

...Zgjill cili në shqipri, ashtë ma i poshtër se të tjerët...

...Nuk ka burr çi e din,...

....Mali i zi 700 -- 800 mij banore e dalin 3000 vete e punojn atje ,nuk arrij me kuptua...

....miku e shpëtova at subjekt që Don me votua aman mos e harxho veten po ma jep mua haaaa

...ka kohe qe,ste kam pa ,a je knej apo ke ike prej Shqipnise... Siç shihet, aty janë këto dallime: përdorimi i grupit **ua** në vend të **ue**; **ll** për **dh**; **n** për **nd**; si dhe leksik: **pesha** për **gurë**; **njara** për **njëra** etj.

Aty më sipër solla disa shembuj të përdorimit të disa nuancave dalluese gjuhësore mes grupeve etnike që sot jetojnë në Zadrimë. Sigurisht, ato janë veçse pak nga ato që më përpara ishin mjaft të theksuara dhe veç disa që shfaqen në shkrime për inerci të zakonit e shprehive të ngulitura, pasi, siç e cilësuam, ndryshimet e sotme që kanë shkuar drejt unifikimit, ashtu si edhe mjaft

zakone e tradita dhe përdorimi gjithnjë e më rrallë i veshjeve tradicionale, e kanë mbushur atë hendek mjaft dallues mes grupeve etnike. Sot flitet e shkruhet veç me gjuhën e moderuar të fituar gradualisht në shkollat e unifikuara dhe jashtë dialektalizmave e shprehive të ngulitura krahinore. Ndoshta në të folur të përditshëm, të gjithë ata që e shkruajnë normën letrare e flasin ende atë gjuhë të dallueshme krahinore me nuanca disi të zbutura, tashmë, ndaj nuk është e lehtë të gjenden edhe në shkrime nuanca të vogla dalluese tek të gjithë ata përfaqësues të grupeve etnike.

Po kështu, gjithnjë e më rrallë gjen identitete etnike duke u bazuar nga veshja dhe këtë e patëm theksuar edhe më sipër, pasi shumica e grave përdorin veshje jo tradicionale. Këtu nuk po flas për vajzat, se për ato do të thosha se të gjitha pa asnjë përjashtim përdorin veç veshje unike të kohës dhe nuk mundesh të vësh gishtin e të tregosh se kjo vajzë, apo ajo grua i përket ex etnie, pasi nuk mund ta dallosh në paraqitje, veç në mos i sheh duke manifestuar në evente të ndryshme sociale, si koncerte apo manifestime popullore, siç i kemi thënë edhe më sipër dhe i kemi ilustruar edhe me foto të ndryshme. Dallimet sot mund t'i gjejsh veç tek brezi i tretë, madje edhe aty jo në përgjithësi.

Po kështu edhe mjaft zakone e tradita kanë ndryshuar dhe nuk bëhen më si më përpara të plota, por në pak ose aspak elemente pothuajse fare të padallueshme. Sot edhe dasmat kudo po bëhen unike, madje edhe pa asnjë

dallim, jo vetëm mes grupeve të ndryshme etnike që ka Zadrime, por edhe në të gjithë kombin e përtej tij. Pra, mund të themi se sot, secili mund të etiketohet veç me vendin ku jeton dhe jo me origjinat e largëta, siç po bëjnë disa: zadrime, mirditorë, malësorë, kallmetorë, a çdo gjë tjetër që mund të mbetet si trashëgimi nga e kaluara si një relike dëshmuese origjinash. Në Mirditë e as në Dukagjin, sot, e kam fjalën për ato pak familje që kanë mbetur atje, askush nuk i nis krushqit një natë më parë për të marrë nusen ditën tjetër dhe nuk e besoj se ende ekziston ky zakon atje, po jo e jo në Zadrime tek ai grup etnik. Kjo ka ndodhur edhe për arsye të infrastrukturës së sotme në çdo skaj të vendit. Kudo ka shkuar rruga e makinës dhe kudo mund të shkohet atje ku dëshiron brenda kohës së duhur (brenda ditës duke arritur në kohën e duhur) me mjete automobilistike. Dasmat sot bëhen nëpër lokale dhe askush nuk vuan të rreshtojë miqtë e ftuar sipas rangut e taraveve përkatëse dhe as sipas bajraqeve të etiketuara dikur në kohën paramoniste e pak përgjatë saj edhe pak si fshehtas, veç si zakon nga e kaluara.



Gjatë një mitingu në zonat e Zadrimës. Në të dyja këto foto nuk mund të shihet pothuajse asnjë grua me veshje tradicionale, çka e tregon faktin se sot nuk mund t'i dallosh etnitë nga veshja.


Këtu më poshtë po paraqes disa foto ilustruese nga etnitë zadrimore dhe të tjera etni që jetojnë në Zadrimë.



Momentet e marrjes së nuses zadrimore. Vjehri dhe vjehra e shoqërojnë atë.



Gra me kostume popullore ku në të majtë paraqitet një grua me veshje tradicionale zadrimore.



Një çift zadrimer i kohës marubiane.



Gra e vajza nga Dajçi i Bregut të Bunës.



Portret nuseje zadrimore.



Babë e bijë në Blinisht në një ekzekutim të një kënge zadrimore.



Kostume tradicionale të Dukagjinit.



Luftëtarë zadrivorë komitë të Çetës së Bregut në kohën e pushtimit turk.



Gra dhe vajza nga Kallmeti



Një grua dhe një vajzë me veshje të etnisë kallmetore.



Dasma në Rranxa në epokën e tranzicionit monist.



Gra dhe vajza të hershme dukagjinase.



Grua dhe nuse mirditore. Riti i shoqërimit të nuses tek burimi.



Gra të zonës së Rranxave që shoqërojnë nusen. Kjo foto duket që i takon tranzicionit monist.



Shoqërimi i nuses nga gratë zadrimore në tranzicionin monist.



Vajza zadrimore të epokës së tranzicionit monist të kulturës popullore.



Nuse mirditore.



Nuse malësore.

Pasi bëra këtë ekspozitë në paraqitjen e grupeve etnike duke hedhur dritë në etnogenezën dhe evolimet e tyre nga koha në kohë, dua të kthehem edhe një herë që nga

pikënisja e këtij shkrimi, tek ajo pikë që më nxiti të ndërmarr këtë nismë për të bërë këtë ekspozë.

Zhurmnaja e pakuptimtë e sotme për origjinën e At Gjergj Fishtës, më duket jo vetëm absurde, por edhe e pavend për t'u bërë. Së pari duhet ta dimë se At Gjergj Fishta nuk i përket vetëm një grupi njerëzish, por krejt kombit shqiptar, pasi ai ishte një figurë madhore që e njuh, tashmë, çdo shqiptar në çdo vend që ndodhet, në Shqipëri, jashtë kufijve shtetëror, në diasporë e kudo. Ai mbrojti interesat mbarëkombëtare dhe jo vetëm të një pjese të kufizuar njerëzish. Së dyti do të thosha, Ai nuk ishte ai që ishte për meritën e askujt, por falë zotësive të tija intelektuale, falë gjenialitetit të tij të lindur, falë shpirtit të tij patriotik dhe për meritën e askujt tjetër që këmbëngul në origjinën e tij mirditore, apo zadrimore.

Kjo luftë absurde ka shpërthyer sidomos në rrjetet sociale dhe kryesisht në Facebook përmes statusve të ndryshëm të përdoruesve të këtij rrjeti. Aty jepen lloj-lloj argumentesh duke u mbështetur edhe mbi bazën e dokumentave të mbledhura andej-këndej dhe duke aluduar sipas oreksit të tyre. Absurditeti arrin kulmin kur dikush e thekson se falë origjinës së tij mirditore dhe falë nxitjeve të abatit të Mirditës, shkroi veprën madhore “Lahuta e Malësisë”. Ja si shprehet një prej tyre në një koment mjaft të stërzgjatur që unë po e sjell këtu veç një pjesë të tij, pasi statusi është mjaft i gjatë:

“ Mjafton të përmendim shërbimin e Pader Gjergjit

*në Mirditë, menjëherë pas Troshanit, ku u njoh me Abatin e Mirditës Preng Doçin dhe së bashku themeluan alfabetin e shoqërisë “Bashkimi” në Shkodër në vitin 1899, pra 9-vite para kongresit të Manastirit, shkollat e para shqipe që nga Shkodra e deri në Mirditë u hapën dhe shkruanin **germat shqip falë Abatit të Mirditës dhe Pader Gjergj Fishtës.***

*Mos të harrojmë se **Fishta** sëbashku me **Luigj Gurakuqin** ishin të deleguarit e Abatit të Mirditës që të prezantonin alfabetin e shoqërisë “**Bashkimi**” në Kongresin e Manastirit në vitin 1908.*

*Gjithashtu Abati i Mirditës **P.Doçi**, frymëzoi dhe i qendron pranë Pader Gjergjit në aktivitetin e tij patriotik kombëtar, se Pader Gjergji ishte shumë me i ri se Abat Doçi i cili kishte një historik të përparshëm shumë të fortë për çështjen kombëtare.*

*Gjithashtu, ju kujtoj se Abati i Mirditës **P.Doçi** nxiti **Fishtën**, të shkruante “**Lahutën e Malcis**” dhe ky fakt është i shkruar në parathënien e disa botimeve të “**Lahutës së Malcis**” në Romë, ku At’Pashk Bardhi miku i ngushtë i Fishtës dhe bashkmoshatar i tij, ku së bashku me Fishtën mbaruan studimet në Bosnjë, shkruan mes të tjerash:*

Abat i Mirditës P.Doçi-Pader Gj.Fishtës:

*–**Lahuta e Malcis**—asht një gja krejt e jona.*

*Pra Pader Gjergji, vijo me punue në << **Lahutë të Malcis** >> pse ke me i lanë namë vedit e një kryeveper literatures ë s’onë kombtare-. Kështu At Fishta muer*

zemër,vijoj botimet mbi << Lahutë të Malcis >>,e sot kemi edhe një epike kombtare të shkrueme mjeshtrisht.

Pader Gjergj Fishta ne takimet qe zhvillonte te kisha e Arrës se Madhe në Shkodër, kur e pyetnin të rinjtë: Kush është per Ty, Abati i Mirditës P. Doci? -“Une prej Tij kam mesue si ti baj roje Flamurit, Gjuhes edhe Kombit tone”, pergjigjej Fishta menjehere, duke u ngritur ne kam në shenjë nderimi për Abat Doçi e Mirditës!

Po ju kujtoj kordinimet që Abati i Mirditës P.Doçi kishte me Pader Gjergj Fishtën edhe për organizimin e kryengritjeve për pavarësi :..... etj. A ka absurditet më të madh se kaq?! Aty, gati sa nuk thuhet se “Lahutën e Malësisë” e shkroi me urdhër të Abatit të Mirditës Prengë Doçi, i cili e kishte urdhëruar që Gjergj Fishta të kryente veç rolin e qatipit aty, se Abati po ia diktonte të gjithë ato çka dëshironte ai të shkruante dhe nuk ishte aspak krijimtari e pavarur e Fishtës.

Nga ana tjetër, mbështeten në thënie e gojëdhëna të ndryshme se gjoja vetë Gjergj Fishta e paskësh thënë se ishte nga Domgjoni i Fanit dhe se tokat që kishte lënë atje, as i kishte falë dhe as i kishte shitur. Pra, mund të themi se pasardhësit e vëllait të tij sot paskan troje dhe toka në Domgjon dhe kur të duan mund të shkojnë atje e t'i marrin. Por paskan një problem, se në Fishtë, aty ku ka qenë vendlindja e Fishtës, ia paskan rrëmbyer padrejtësisht trojet disa që nuk janë fis me të,

por e thonë këtë gjë pa baza. Pra vijnë që nga Mirdita dhe e përcaktojnë në Zadrimë se kush është fis dhe me kë, si dhe ia përcaktojnë se ku i paska pasur trojet e tij At Gjergj Fishta, sikur stërnipat e tij nuk ekzistuan sot atje në Fishtë. Gjejnë kushërinjtë dhe lidhjet e gjakut në Domgjon e nuk po mundkan me i gjetë lidhjet fisnore fishtakët vetë, por vijnë nga larg dhe ua përcaktojnë se kush e me kë janë kushërinj.

Duke i pasur mundësitë ta studioj gjenezën e vëllait të At Gjergj Fishtës sipas regjistrimeve austriake të popullsisë të vitit 1918, kam vërejtur se në Fishtë janë disa familje që kanë pasur të njëjtin mbiemër familjar e pikërisht mbiemrin SIMONDOCEJ. Megjithatë, kjo nuk ma jep të drejtën të them se janë ose jo nga Fani e nga Domgjoni. Këtë të drejtë e kanë pinjollët e atyre familjeve pasuese të të parëve të tyre. Mua më takon të flas e shkruaj veç për fisin dhe fshatin tim, dhe jo për fise e banorë të fshatrave të tjerë, se nuk është interesi im vetiak, se nuk jam kompetent për ta bërë, se ka plot të tjerë që mund ta bëjnë mirë e shumë më mirë se unë. Megjithatë, duke shfrytëzuar lidhjet e mia të gjakut me një kushëri timin nga Fishta (djali i hallës sime), kur e kisha zbuluar se kishin pasur të njëjtin mbiemër me At Gjergj Fishtën në ato regjistrime të sipërpërmendura, e pyeta për origjinën e tij dhe lidhjet fisnore që mund të kishin me At Gjergj Fishtën. Ai më jep këtë përgjigje:
“Te paret tone kane ra nga Domgjoni, duam ne s'duam ne. Kjo eshte nje deshmi e Shuk Markut gojore. Une

isha ne Domgjon ne vitin 2017 e kerkova se mos gjeja ndonje gjurme te fisit tim sepse ne nuk jemi fis me Gjergj Fishten. Ata jane fis Paci ne jrimi fis Curi nga llagapi. Kerkova edhe nder varreza te vjetra afer kishes se Domgjonit por nuk gjeta asnje pllake apo gur te koka e varreve dhe nuk gjeta as me mbiemrin Shtjefni e as nga llagapi Curi. Bile atje takova Lindita Nikollen atehere ministre arsimit. Zadrime ka pase banoret e vet qe nga iliret siq e deshmon Shtjefen Gjecovi, arkeologu i pare shqiptar ku ka germuar tre varre ilire, nje ne Fishte ne koderBogze dhe dy ne Troshan nje koderKuveth aty ku ka shpine Kola i tezes File e deri sot ku 1/3 jane mirditore te rame vone ne Fishte. Fishta eshte banuar nga myslimanet para 1650 vite qe mendohet qe kane ardhe mirditoret e pare qe jane kolecajt. Keto i kam zbuluar nga gojedhanat e pleqve dhe kam edhe deshmi arkeologjike qe i kam zbuluar ne vitin 1977. Megjithate kam pritur nje koment te bukur ngu ty ne ate filmin dokumentar qe shfaqta ne f.b me rastin e daljes ne pension. Ndoshta nuk e ke vene re. Ska gje se kemi kohe me shkruajtur. Edhe Gjergj Fishta origjinen e ka nga Domgjoni siq thone te vjetrit. Per kaq kam njohuri per momentin. Na fal se e zgjata shume!”

Nuk e moderova komentin duke e kthyer në normën gjuhësore, por e lashë ashtu për autenticitetin e saj, po nga sa ai shkruan, tregon se origjina e tij familjare është nga fshati Domgjon dhe madje tregon se kishin

pasur mbiemrin Curi, apo Shtjefni, siç e kanë sot. Duke ditur se mbiemri sipas regjistrimeve austriake kishte qenë Simondocej dhe se gjyshi i tij, të cilin e pata njohur që kur isha fëmijë dhe i ri, se e kishim mik të afërt të familjes, e që ai i paskësh treguar për origjinën e tyre familjare, ashtu siç ma patën treguar edhe mua se jemi me origjinë nga Kushneni, çka është krejt normale për këdo të interesohet dhe ta dijë origjinën e fisit të tij, i shkrova për t'i treguar sa unë dija. Po do të ishte edhe më normale ta thoshte se ishte edhe zadrimer nga Fishta me etni gjuhe, zakone, tradita e veshje tradicionale zadrimore. Kur pata shkruar librin “Kënga dhe rituali i dasmës zadrimore”, më pati përgëzuar dhe më pati thënë se i kishte zbatuar një për një ritet e dasmës zadrimore. Pra, vetë ai e kishte deklaruar se i ndiqte traditat e zakonet zadrimore dhe jo mirditore.

Edhe nga njohjet e mia të afërta të familjes së tij, e di mjaft mirë se gjyshi dhe gjyshja e tij ishin me tradita zadrimore dhe jo mirditore, po kështu edhe nëna e tij (motra e babait tim) si dhe nusja e xhaxhait të tij ishin zadrimore puro, prandaj ai duhej ta thoshte këtë gjë mes të tjerave. Ndoshta ai po më fliste për origjinën e jo për etninë, apo grupin etnik dhe këtu mund t'i jap të drejtë konstatimit të tij, por ai dhe kushdo tjetër duhet ta dijë mirë se tjetër gjë është origjina dhe tjetër gjë janë traditat, zakonet, veshjet dhe nuancat gjuhësore që praktikojnë dhe që janë elemente që përcaktojnë grupin etnik. Të gjitha këto që përmenda, i ka krejt të

ndryshme nga origjina e tij, ndaj nuk mund të përputhet origjina me etninë.

Konfuzitetin e tij e shpreh edhe në përgjigjen e tij pas sqarimeve me dokumenta e argumenta që i kisha dhënë: ***“Te falenderoj Tom per te gjitha sqarimet ! Qe kemi lindur ne Zadrime e dime pasi te gjithë disponojme certifikata lindjeje. Edhe per prinderit e dime se kane lindur ne Zadrime. Edhe gjysherit, stergjysherit po ashtu. Por me tej?”*** Pra më tej ai nuk ishte në gjendje ta dallonte se në Fishtë kishte disa familje, jo vetëm me origjinë nga Mirdita, por edhe me zakone e tradita të mirëfillta mirditore, çka familja e tij nuk i pati pasur prej disa brezash e kjo do të mjaftonte ta dinte përfundimin për ***me tej?***

Më keq akoma është se nëpër rrjete sociale shprehet një mllef i ashpër nga disa ithtarë të thekun të origjinës mirditore të At Gjergj Fishtës duke përdorur edhe fjalë fyese dhe agresivitet mjaft të ashpër. Duke sjellë ndërmend këto gjëra, m'u kujtua një anekdotë e thënë për diktatorin Enver Hoxha: “Enver Hoxha e donte shumë Shqipërinë, por e donte veç për veten e tij. Nga dashnia e madhe që kishte për të, e kishte shtrënguar aq shumë, sa ia mori frymën dhe e mbyti fare”. Kështu po më duket edhe sot me ata që mendojnë ta privatizojnë figurën madhore të At Gjergj Fishtës, që në vend që ta promovojnë si figurë madhore mbarëkombëtare, po e minimizojnë duke e bërë një figurë minore krahinore, thua se i përket vetëm një krahine të vogël apo dhe veç

një fshati të humbur diku mes malesh dhe jo një figurë që i përket krejt kombit, ashtu siç i përket krejt kombit edhe figura madhore e Gjergj Kastriotit. Kështu, mendoj unë, po i bëhet një atentat i panevojshëm asaj figure madhore dhe kjo s'është aspak e mirë, por e padenjë për këdo që mendon të nxjerrë profit moral nga kjo gjë me një legalizim të pamërituar e të pavend.

Në diktaturën komuniste trupi i At Gjergj Fishtës u zhvarros dhe eshtrat ia hodhën në ujërat e Kirit e të Drinit, një veprim të kryer më herët nga turqit me eshtrërat e Skënderbeut, Heroit tonë Kombëtar. Por, në mënyrë simbolike po ndodh edhe në demokraci sot që me veprime të tilla, jo po e zhvarrosin, por më keq po e baltosin figurën e tij. Sot mund të shkruash dhe të thuash çfarë të duash, mjaft që të mos fyesh askënd dhe po qe se thua të pavërteta, koha dhe studiues të tjerë mund të të atakojnë me shkrimet e tyre kritike mbështetur mbi bazë dokumentash dhe faktesh të pakundërshtueshme e bindëse, po qe se kanë, ose heshtin pa pasur të drejtë që të ndër marrin akte agresive të tipit të djegies së librave.

Ka edhe mjaft të tjerë që kanë bindje të ndryshme e i shprehin në mënyrë të qytetëruar, megjithëse shpesh edhe duke sjellë fakte e argumenta bajate dhe pa baza bindëse. Kështu, statusit tim prononcues, njëri prej tyre i përgjigjet kështu: *“Eshte e drejta juaj te parashtroni ç'të doni...dhe, asgje te keqe nuk shoh ne kete mes...*

Por, nese ju thoni t'ua lëmë historianëve...une, i diplomuar per Histori jam, madje, i vleresuar me noten maksimale te mundshme...

.....(dhe sjell argumenta për ndërrime mbiemrash, pasi unë kisha thënë se vetë i madhi Gjergj Fishta e kishte përcaktuar vetë origjinën e tij duke ndërruar mbiemrin e tij nga Ndoka në Fishta dhe jo Domgjoni, siç pretendohet nga disa për vëndorigjinë)

Shembull klasik mbarekombetarë, e nderkombetarë...Xhon dhe Xhim Belushet e famshem...ikur nga Korça para afer 2 shekujsh...e deklarojne me krenari ORIGJINEN SHQIPTARE... Madje, keto dite, Xhim Belushi, eshte ne Tirane...me staf profesionistesh...per te bere nje dokumentarë mbi Tiranen...dhe per ta shfaqur ate ne te gjitha ekranet kryesore AMERIKANE...

Pooo....perse e ben ai kete?!...

Per krenarine e GENIT TE TIJ...të ORIGJINES SE TIJ...SHQIPTARE...

Dhe...kush eshte Amerika, pà?!...Suppershteti, qe do te bente edhe nje shtetas te ri shqiptaro - amerikan...ne kuptimin, te shkuar rishtazi atje...te deklarohesh "amerikan" dhe jo shqiptarë...per megallomani...

Por, ky, i biri i botes, Xhim Belushi (dhe i vellai)...ne kulmin e karrieres...u VETEDEKLARUA SHQIPTARË... ndoshta, duke marre persiper edhe nje rrisk "zhvleresimi" te fansave dhe opinionit publik

atje...te tipit..."hajt,mo,se nje cope provincial,nga nje vend "i humbur" paska qenë ky(?!...)..."

Por...nuk e la rehat...GENI...ORIGJINA e thirri te shprehej...dhe u shpreh...

Mire keta...BELUSHET...po Robert De Niro,ç'pati?!...

Askush nga ne,nuk e dinte...por...ndergjegja e thirri ne APEL..."deklarò qe je shqiptarë"...

Gjaku nuk shprishet kurre,miku im...Dhe,ju,e dini po kaq mire sa une..."

dhe në një vend tjetër po ky historiani deklaroi:

"Ngado qe ta sjellësh muhabetin...vetem ZADRIMORË nuk eshte Fishta..."

Një arsyetim dhe një krahasim krejt pa vend, thua se pikërisht geni i të qenit shqiptar për ato dy figura arti të botës së sotme ishte krejt përcaktues në rrugën e tyre të suksesit, thua se të gjithë artistët me famë të botës sot, doemos duhet ta kenë genin shqiptar, se ndryshe nuk duhet të ishin aq të famshëm, apo poetët e shkrimtarët e tjerë të mëdhenj nga bota, përsëri e kanë genin shqiptar. Kjo ka çuar në hamendësime edhe mjaft të tjerë, sa dhe poetin e lashtësisë Homerin e kanë nxjerrë me origjinë ilire e, po të nisesh me arsytetime të tilla minore, nuk është gjë çudi që edhe atë ta nxjerrin fis me Gjergj Fishtën, pasi edhe ky i fundit është quajtur Homeri shqiptar. Jo, zotërinj, geni i të qenit mirditor, apo zadrimor, nuk ishte e nuk është përcaktues për t'i arritur ato përmasa sa ç'i kishte e i ka figura madhore e At Gjergj Fishtës, se ndryshe, të paktën, gjysma e

mirditorëve do të ishte Gjergj Fishta me famë e zotësi intelektuale, siç i kishte Ai.

Për t'i konceptuar bazat e polemikave të mia me të tjerët, këtu më poshtë po paraqes disa nga statuset e mia në formë polemikash:

Komenti im tek intervista e Llesh Dodës:

“Nuk e kuptoj pse njerëzit mundohen të nxjerrin për Gjergj Fishtën një tjetër origjinë, kur vetë i madhi Gjergj Fishta e ka vulosur origjinën e tij që në mbiemrin e tij, duke e ndërruar nga Ndoka në Fishta e jo Domgjoni. Kjo, që të kërkosh ta nxjerrësh nga Domgjoni, më duket tejet qesharake dhe një përpjekje krejt pa vend. Gjergj Fishta ka lindur në Fishtë të Zadrimës dhe para tij edhe babë e babëgjysh. Zakone, tradita, veshje e gjuhë, i kishte krejt zadrimore dhe aspak mirditore, siç hala i kanë shumë e shumë të tjerë me origjinë mirditore që kanë më shumë se një shekull që kanë rënë me banim në Zadrimë dhe i ruajnë me fanatizëm veshjet dhe gjuhën e zakonet e vendeve nga kanë origjinën. Shumëkujt prej nesh, për të mos thënë të gjithëve na bie të kemi kushërinj në vende të ndryshme. Ndoshta edhe vëllezër, por kjo nuk do të thotë se jemi, amerikanë, australianë, anglezë, italianë, gjermanë, francezë.... e shumë e shumë vende të ndryshme të botës nga na janë shpërndarë njerëzit tanë e ne me ta. Gjergj Fishta i përket së pari Familjes së vet Ndoka nga e cila lindi dhe u rrit, i përket fshatit të vet

Fishta ku lindi dhe pa për herë të parë dritën e diellit dhe që, kur u rrit e mori famë, e ndau me të duke e skalitur në mbiemër për nder të origjinës së tij, i takon Zadrimës që e mëkoi bashkë me bukën e ujin edhe me zakonet e traditat e shkelqyera që i ka dhe i ruan me mjaft nderim edhe sot e kësaj dite, i takon Shqipërisë dhe mbarë kombit shqiptar, për të cilin punoi e shkroi plot pasion e përkushtim. Duhet të themi: Shyqyr që nuk po na e kërkojnë maqedonasit, serbët, apo boshnjakët me na e marrë, siç patën këmbëngulur për Gjergj Kastriotin dikur, njëherë e njëkohë.

Para pak kohësh, duke gjurmuar rrënjët e dikurshme të fisit tim nga ku kisha dëgjuar gojëdhëna se ishim shpërngulur para 300-350 vitesh, kisha kërkuar të kontaktoj njerëz nga ajo zonë e ai fshat nga thuhej, për të ditur se a kemi farë e fis tjetër atje, por nuk arrita të marr informacion. Dikush më orientoi të kontaktoja bajraktarin e atij fshati e bajraku dhe unë, ngaqë nuk i kisha mundësitë e takimit nga afër, i dërgova një ftesë që të bëheshim miq në Facebook, ku mund të bësh miq, jo vetëm nga zona jote, jo vetëm nga krahina, madje, jo vetëm nga Shqipëria, por, po dëshirove, nga të katër anët e botës. Përfundimi: një refuzim i gjatë me heshtje totale. Thashë me vete: Mos u shqetëso për ta kërkuar origjinën tënde prej më se 350 vitesh, kur as bajraktari i zonës nga pretendon se e ke atë origjinë të largët, nuk të përfill! Dhe a e dini pse? Se unë nuk isha Gjergj Fishta. Se unë nuk e kam famën e tij dhe s'mund

ta kemë, se fama ime nuk i kalon caqet e fshatit tim nga ku jam lindur dhe jam rrituri dhe se i përkas vetëm familjes dhe njerëzve të mi të afërt që më duan dhe i dua pa shpërblime. Kjo është e gjitha. Po të isha si i madhi Fishta, nuk e di se prej nga do të dilnin vëllezër e vëllezëri që do ta kërkonin me këmbëngulje origjinën time.

Replikë me një komentues:

“I nderuar zotëri P. Ll.! Nuk ju njoh dhe besoj se nuk më njihni, qoftë nga afër, qoftë edhe nga ana e kapaciteteve të mia intelektuale, por nuk e kuptova se cila ishte vërejtja juaj në drejtim të komenteve të mia?! Unë në asnjë rresht e në asnjë fjalë nuk e cilësova se origjina e Gjergj Fishtës nuk është nga Paci i Domgjonit, por kam theksuar se vendlindja e Tij dhe e babë e babëgjysh janë në Fishtë të Zadrimës dhe nga ana tjetër, kam theksuar se familja e tij e ai vetë kishin gjuhë, zakone e tradita zadrimore, çka ndryshojnë në shumë pika me ato mirditore dhe kjo e bën që t'i përkasë etnisë zadrimore dhe jo asaj mirditore. Përsa i takon origjinës së largët të tij, unë nuk e diskutoj, pasi duhen studime që ju i keni bërë tashmë dhe nuk i vë në diskutim. Kam thënë, gjithashtu, se Gjergj Fishta i takon Fishtës, i takon Zadrimës, i takon Shqipërisë dhe mbarë kombit shqiptar dhe kjo është e vërteta më e madhe. Kam theksuar gjithashtu, se edhe gjuha e përdorur në të gjitha shkrimet e tij është gjuha

autoktone e krahinës së Zadrimës dhe jo e Mirditës, gjë që, po të jesh edhe ti një njohës i mirë i gjuhës ashtu siç jam unë, do ta vëreje edhe ti pa aspak vështirësi.

Originën mirditore në Zadrimë e kanë shumë familje, për të mos thënë shumica, por të rënit në Zadrimë herët i ka bërë të asimilohen, ndërsa ato familje që kanë rënë aty pak më shumë se një shekull e më vonë, i ruajnë ende traditat mirditore, çka familja e Gjergj Fishtës nuk i ka, as fisi im që ka qenë, besoj, i njëkohshëm me fisin Simondocej të At Gjergj Fishtës. Unë, pra, si origjinë të hershme e kam nga Mirdita dhe nuk ka rëndësi për ty ta dijsh se nga, por po ta them se, duke qenë se kanë rënë në Zadrimë shumë herët, po aq sa edhe të parët e At Gjergj Fishtës, jemi asimiluar dhe përqaftuar etninë zadrimore, duke u ndjerë 100% zadrimore me të gjitha, gjuhë, zakone, tradita dhe veshje e aspak mirditorë. Ky është realiteti që unë njoh dhe aspak ndryshe, e duam apo s'e duam ne.

Pra e theksoj se Gjergj Fishta i madh nuk i përket tashmë vetëm Fishtës, as vetëm Zadrimës, madje as vetëm fisit të tij, por mbarë kombit shqiptar. Kjo është e gjitha dhe diskutimet e tjera janë fare pa bukë!

(këtu nuk e kam shkruar emrin e debatuesit, por veç inicialet, gjë që besoj se është brenda etikës sime dhe këtë gjë do ta vazhdoj edhe në replikat e tjera edhe me të tjerë replikues.)

Replikë e dytë:

I nderuar zotëri P. Ll.! Askush, por unë, të paktën nuk e vura në dyshim atë prejardhje, i nderuar. Por, kur edhe ti e shkruan: *“Fisi i im-tha- Kol Paci- u themelue në Fishtë nga dy djem prej shtëpijës s’ime, të cilët ranë spari n’atë vend tue kerkue vrri per gjatë. Disa vjet erdhne per verime. E pra këtu i kanë trojet e vjetra e as nji send nuk e kanë shitë as t’eger as të butë”*, unë nuk kam çfarë shtoj tjetër, kur plaku i nderuar e paska deklaruar vetë se fisi i tij qenka themeluar në Fishtë, ashtu si edhe fisi im është themeluar e zhvilluar në Kodhel, jo fort larg nga Fishta, afërsisht katër, ose pesë km që nuk e kalojnë një orë me këmbë dhe e theksova se kemi rënë nga diku prej Mirdite(kjo nuk përbën ndonjë rëndësi), por ndjehem zadrivor 100%, ashtu siç ndjehej edhe At Gjergj Fishta dhe pasardhësit e tij, nipat e stërnipat e tij. Unë nuk flas për manipulimet, por për të vërtetat e realitetit. Sa për atë që thoshte Fishta i madh, them se janë plotësisht të vërteta, pasi edhe gjyshi im, shpesh ma pati përsëritur se deri para Luftës së Parë Botërore (kur filloi ajo luftë, ai ishte 16 vjeç, në moshë mjaft të mirë për të mbajtur mend saktë), fisi im kishte lidhje dhe marrëdhënie ekonomike me fisin e fshatit (bajrakut) nga kishin ardhur 250 vjet ma parë, pasi nuk i patën shitë tokat. Ata sillnin pjesën e gështenjave e gjëra të tjera dhe merrnin pjesën e drithërave që prodhoheshin në tokat e fisit tim. Megjithatë, gjyshi im, por edhe i ati e gjyshi i tij ishin dhe ndjeheshin zadrivorë edhe pse një pjesë të

fisit e kishin andej. Më fal për modestinë e munguar në këtë rast, por edhe unë kam shkruar jo pak libra të ndryshme, por, kur u përpoqa të kërktoj rrënjët e mia andej nga fshati mirditor, nga edhe fisi im kishte rënë, jo vetëm që askush nuk m'u përgjigj pozitivisht e të më ndihmonte, por edhe kur i shkrova vetë bajraktarit të atij bajraku e i tregova se kush isha dhe se çfarë qëllimi kisha, jo vetëm që përgjigje nuk mora, por as më pranoi të bëheshim miq në Facebook, pasi ma refuzoi ftesën time. Besoj se edhe ti e kupton "Pse-në" e kësaj gjëje, se gjithkush e kupton: Se unë nuk isha dhe nuk mund të jem asnjëherë At Gjergj Fishta i madh që tashmë e njeh dhe e do një komb i tërë dhe jo vetëm Zadrime, dhe jo vetëm Mirdita. Kjo, mendoj se mjafton si argument për të gjithë debatuesit e kësaj çështjeje. Për më shumë se kaq dhe për imtësitë e tjera, unë them se i madhi At Gjergj Fishta, ka plot nipër e mbesa nga vëllai i tij Lekë Ndoka dhe një pjesë mjaft e mirë të mjaft mirarsimuar me fakultete të ndryshme universitare dhe më mirë se këdo tjetër, pyetini ata/o, se ata/o e dinë më mirë se kushdo tjetër origjinën dhe etninë e tyre. Askush nuk duhet ta ngatërrojë origjinën me etninë, pse janë dy koncepte jo të njëjta, megjithëse nganjëherë e plotësojnë njëra-tjetrën. Po qe se ata/o thonë se janë e ndjehen mirditorë, atëherë problemi i juaj është krejt i zgjidhur. Besoj se këtë gjë, ata më shumë se kushdo tjetër, as ti e as unë, por veç ata/o

kanë të drejtë të japin objeksionet e tyre për etninë e tyre.

Respekt për ju, i nderuar z. P. Ll.

Replikë e tretë:

P.Ll., keni të gjithë respektin tim dhe asnjë pikë dyshimi për argumentet që ju sillni. Unë njoh atë realitet që jua përshkrova dhe nuk kam forcë as unë e askush tjetër që ta ndryshojë, as me komente e as me gjetje artificiale. Je shumë i saktë, besoj kur shpreh historinë e të rënit në Zadrinë, dhe kësaj nuk i heq as pikë e as presje. Ashtu, besoj ka ndodhur. Shkrimet e tjera, të vërteta e të pavërteta, janë krejt pa vlerë para realitetit ekzistues, pavarësisht që dikush e dëshiron, ose jo. Sa për të ta treguar, se edhe librat nganjëherë gabojnë, po të them se kur u shkrua tek libri ZADRINA LETRARE ku isha njëri bashkautor, edhe pse materiali m'u sërviu para botimit të librit, pasi nuk isha unë ai që e kisha bërë paraqitjen dhe jetshkrimin për At Gjergj Fishtën, ishte bërë një gabim, por unë nuk e kisha vërejtur dhe aty është bërë me atë gabim. Dhe e di cili ishte gabimi? Ishte se thuhej se nëna e Gjergj Fishtës ishte nga Kotri, që në fakt, unë e di më mirë se kushdo që ishte e gabuar. Kam frikë se as pasardhësit e tij nuk e dinë aq saktë sa e di unë, por megjithatë, në libër u la ashtu gabim, se nuk isha treguar i vëmendshëm ta kisha pikasur dhe ta kisha kundërshtuar. Sipas diskutimeve të mëvonshme, më

është thënë se ishin bazuar nga shkrimet e Leonardo de Martinos, që nuk e di a është ashtu, ose jo, pasi nuk e kisha verifikuar vetë personalisht. Pse e ëma e Padrit të madh nuk ishte nga Kotrri, por nga Shelqeti, kam pasur dhe kam argumente të fuqishme, jo me shkrim, por gojore dhe reale, gjë që s'e besoj se është e nevojshme me t'i shtjellu, se nuk po bëhet debati për këtë gjë.

Edhe një fakt tjetër shumë shoqërisht desha me ta saktësu se At Gjergj Fishta në Fishtë ka një fis të vogël me mbiemrin e sotëm Ndoka, por ka një fis ma të gjerë se ai që kanë marrë mbiemra të tjerë dhe i gëzojnë sot si Frani, Shtjefni, Gjeka, Simoni, e të tjerë. Mbiemri i tyre deri më 1918, kur u bënë regjistrimet austriake të popullsisë, të gjithë këto fise e familje dalin me mbiemrin **Simondocej** dhe nuk janë pak.”

Replikë me një tjetër debatues:

“I nderuar Gj. T.! Nuk dëshiroj të futem në polemika pa vend e pa nevojë me askënd, por dëshiroj të përsëris se Gjergj Fishta i përket të gjithë kombit shqiptar dhe këtu merr fund çdo diskutim. Po qe se diskutohet se cila është origjina më e afërt, jo vetëm me vendlindje, por edhe me zakone, gjuhë e tradita, ajo i takon Fishtës së Zadrimës dhe askujt tjetër. Për origjinat e mëhershme, shumëkush prej nesh mund ta përcaktojë: mirditore, dukagjinase, malësore (Malësia e Madhe), kosovare, apo dibrane, ashtu siç e di vëndorigjinën e largët apo të afërt. Unë nuk e di ekzakt se nga e ka

origjinën Gjergj Fishta, por di ekzakt se nëna e tij ishte zadrimore nga fshati Shelqet i Zadrimes, andej nga ishte edhe nëna e babëgjyshit tim dhe që ishte motra e nënës së Gjergj Fishtës. Të tjerat le t'ia lëmë historisë dhe fishtologëve ta zbulojnë e ta shkruajnë. E kam theksuar se ai i dha vetes mbiemrin Fishta dhe asnjë mbiemër vendi tjetër, por po e theksoj se në të gjitha librat e tij të shkruara prej dorës së tij, nuk gjen asnjë nuancë gjuhësore krahinore të Mirditës. Po qe e kundërta, kërkoj ndjesë për këtë diskutim me ju, për të cilin, edhe pse nuk ju njoh, ju respektoj.”

Nuk solla këtu polemikat e të tjerëve të plota që janë të shumta në fakt dhe që kapen pas fijeve të kashtës për argumente të ndryshme, pse mendoj se nuk ia vlen që t'i paraqes këtu si shembull, por po paraqes një fakt që mendoj se nuk qëndron fare si argument. Ata që ngulin këmbë fuqishëm për origjinën mirditore të Gjergj Fishtës, sjellin si argument edhe emrin e vëllait të tij të ndjerë, Çupit, që gjoja qenka i trashëguar edhe sot e kësaj dite në Domgjon. Për mendimin tim, ky argument nuk qëndron aspak për dy arsye kryesore: e para se kudo në Mirditë e gjen këtë emër burri, por edhe si mbiemër, po kjo nuk do të thotë se është gjithandej si origjinë; së dyti nuk e kam dëgjuar se as nga fëmijët e as nga nipat e stërnipat e Lekë Ndokës të përsëritet si emër, qoftë edhe si përkëdheli. Në Domgjon, ndoshta, po kjo s'ka lidhje domethënëse për fakt origjine.

Ka edhe një fakt tjetër tek ata, pasi, aty ku atyre u përshtatet, pranojnë në përbërje të fisit të Fishtës dhe ku nuk u intereson, këmbëngulin me forcë se nuk janë të të njëjtit fis, por i quajnë fabrikime, siç është rasti i familjes Frani që ishin një familje e madhe me herët. Që kishin të njëjtin mbiemër (SIMONDOCEJ), e vërtetojnë edhe regjistrimet austriake të vitit 1918 dhe kushdo mund ta gjejë tek libri i Evaristo Colit me titull: Lezha 1918 faqe 321-326.

Këtu mund të sillja edhe mjaft polemika të tjera dhënë edhe në bokset e mesazheve, por mendoj se esenca e tyre është dhënë qoftë nëpërmjet statuseve, qoftë edhe nëpërmjet replikave të paraqitura aty më lart e pak a shumë, po ashtu, edhe për shtjellimin e hollësishëm që kam paraqitur në të gjithë fushështrirjen e këtij shkrimi.

Për Gjergj Fishtën janë bërë mjaft studime dhe mjaft shkrime nga shumë autorë dhe këtu, as do të paraqes ndonjë prej atyre shkrimeve, e as vetë nuk dua të flas për jetën dhe veprat e tij se janë mjaft të njohura për të gjithë, por dua të theksoj edhe një herë se ai në të gjitha pikëpamjet i përkiste etnisë zadrimore e këtë mund ta argumentoj edhe nëpërmjet shkrimeve të tij, së pari. Në të gjitha librat e tij, në të gjitha shkrimet e tij, në asnjë vend nuk gjen qoftë edhe një nuancë të vetme të gjuhës mirditore. Këtu më poshtë po sjell poezinë lapidar të

gjuhës shqipe të titulluar “G’juha Shqype” dhe shikoni
nuancat gjuhësore zadrimore e aspak mirditore:

G'JUHA SHQYPE

Porsi kanga e zogut t'verës,
qi vallzon n'blerim të prillit;
porsi i ambli flladi i erës,
qi lmon gjit e drandofillit;
porsi vala e bregut t'detit,
porsi gjâma e rrfës zhgjetare,
porsi ushtima e një tërmetit,
njashtu â' g'juha e jonë shqyptare.
Ah! po; â' e ambël fjala e sajë,
porsi gjumi m'nji kërthi,
porsi drita plot uzdajë,
porsi gazi i pamashtri;
edhë ndihet tue kumbue;
porsi fleta e Kerubinit,
ka'i bien qiellvet tue flutruë
n't'zjarrtat valle t'amëshimit.
Pra, mallkue njai bir Shqyptari,
qi këtë g'juhë të Perëndis',
trashigim, që na la i Pari,
trashigim s'ia len ai fmis;
edhe atij iu thaftë, po, goja,
që përbuzë këtë g'juhë hyjnore;
qi n'g'juhë t'huej, kur s'asht nevoja,
flet e t'veten e lèn mbas dore.

Në g'juhë shqype nanat tona
qi prej djepit na kanë thânun,
se asht një Zot, qi do ta dona;
njatë, qi jetën na ka dhânun;
edhe shqyp na thanë se Zoti
për shqyptarë Shqypninë e fali,
se sa t'enden stina e moti,
do ta gzojn kta djalë mbas djali.
Shqyp na vete, po pik' mâ para,
n'agim t'jetës kur kemi shkue,
tue ndjekë flutra nëpër ara,
shqyp mâ s'pari kemi kndue:
kemi kndue, po armët besnike,
qi flakue kanë n'dorë t'shqyptarëvet,
kah kanë dekë kta për dhë të't'Parvet.
Në këtë g'juhë edhe njai Leka,
qi'i rruzllim mbretnin s'i a, xûni,
në këtë g'juhë edhe Kastriota
u pat folë njatyne ushtrive,
qi sa t'ndrisë e diellit rrota,
kanë me kënë ndera e trimnive.
Pra, shqyptarë çdo fès qi t'jini,
gegë e toskë, malci e qyteta,
g'juhën t'uej kurr mos ta lini,
mos ta lini sa t'jetë jeta,
por për të gjithmonë punoni;
pse, sa t'mbani g'juhën t'uej,
fisi juej, vendi e zakoni

kanë me u mbajtë larg kambës s'huej,
Nper g'juhë shqype bota mbarë
ka me ju njohtë se ç'fis ju kini,
ka me ju njohtë për shqyptarë;
trimi n'za, sikurse jini.
Prandaj, pra, n'e doni fisin,
mali, bregu edhe Malcija
prej njaj goje sod t'brohrisim:
Me g'juhë t'veten rroftë Shqypnia!

Edhe poezia “Dredha e Djallit” që po sjell këtu më poshtë, flet për një nuancë të plotë zadrimore e aspak mirditore.

DREDHA E DJALLIT (1908)

Nuk e dij se është rrënë a prallë,
Por kam ndie qi atjè n' Bisht-Pallë
Per gjith natë, mbasi t' jét errun,
Dalin n' záll! shpirtent e djerrun
E me gurë edhe me tulla
Ngrehin shpija e ngrehin kulla,
Edhë i bâjn me kaq mjeshtri
Pá m'u a pasë ç' do ustaj lakmi.
Por se shka, po duen me thânë,
(T' mos xâjë besë kush s' don me xânë)
Se, kúr del e bardha dritë,
Gjithshka naten t' kén godité,
Ata e shambin rrash per dhé,
Sá, jo veç qi shpë e ré,

Por as gúr, as plang, as tra
Aty mâ s' mundet m' u pá.
Tash, me pasë ndokush me pvetë
Per ketë punë, a thue â' e vertetë?
Kish me thânë (po thom per veti),
Se me ndodhun, kjo punë njeti,
Udobisht s' kish' me b'esue,
Mirë një herë per pa. e peshue.
Por, mbasi, o Shqyptarë të mi,
Bishti i Pallës gjindet n' Shqypni,
Pa e peshue punen fort holle,
E xâ besë se njashtu ndodhë;
Pse zati n' Shqyptari t'onë,
(Duen me thânë 'se âsht kënë gjithmonë,
Por elë mâ tash mâ vonë!)

Âsht zanát me shpartallisun
Çdo punë t' mbarë qi t' jete nîsun.
Prandej thom, se atje n' Bisht-Pallë
Ngrehin çipujt kulla n' zallë,
Per me i çartë mandej prej dritet
Si n'per shekull po perflitet
Paj te tânë e dijn nder né,
N' dashtë t' jen Turq. a t' Kshtênë a Shkjé,
Se kjo namè ka ra nder né,
Qi çdo punë m' u shpartallue,
Mbarë e cilla t' jet fillue.
(Medje na edh' e kem' zanat.
Mos me lânë me shkue fort g'jatë

Por mundoh'mi m'e shperthye
Sà t' két nisë me qitun krye.)
Por kah thoni, o Zotëni,
Se kjo namë ka rá n' Shqypni?
N' paçi ngae ju me m' ndig'jue
Un ktû shqyp due m' ju-a kallxue.

*

Kam këndue m' do libra t' vjeter,
(Se per kúr ata s' kallxojn),
Shêjti Sh' Mhill e Shêjti Sh' Pjeter
Rán n' kuvend me shoqishojn.
Rán n' kuvend tue bisedue
Per punë t' tokës n' â' e madhe a e vogel;
Pse prej s' naltit tu' e shikjue
Thote Sh' Mhilli se âsht sa 'i gogel.
Elè mâ, per mos m1 e ngjatë,
Mos me i mbetë davaja asnjënit,
Zbashkut dán ata m' e matë
Teh e m' teh me 'i fille pënit.
Pra, si fjalët i shtruen per rrashit,
Fluturim mbi dhé ata zdrypen;
Nji lamsh t' madh me pë mundashit
S' dij se kujë atë-botë i a lypen.
Moren pë'n e rane n' Arte,
Me Greqi kû dán Shqypnija,
Si e ka vû Faik Begu n' Kartë,
Qi ka shtypun „Albania“.

Por ka ngae Faik Begu i shumi
M'i-a vû n'leter Shqypnis megjet.
Sá me letra, besa, O r u m i
Vonë e vonë nder mend do t' regjet;
Pse do t' dini ju ket fjalë
Ka bâ bé Gjeka n' Atinë,
Se atij shpirti s' ka me i dalë
Per pa i shty kufijt n' janinë.
Lê' se bé ka bâ Greqija
Me na u shndrrue kufijvet vend,
Por, po thonë se edhë Serbija
Don me u djergun mje n' Pezrend,
E po thonë, se jo per tjetër
Duen Serbjant me marrë Shqypnín,
Qi ata e quejn Serbija e vjetër,
Veç me prû mbrendë qytetnin.
— Marshallà! ç' farë qytetnijet
Na barbart e Kastriotit
Kem' me pasun prej Serbijet,
Kúr „Serbjan" t' na quejn mbas sotit!
Në mos tjetër kem' me u msue
Me thye bén, qi t' bâjm m' therorë;
Grát per s' deknit me i dhunue,
Me pré nierzt, qî t' na bëjnj ndore.
Prap po thonë, se edhe Bullgarvet
Fort po u vesket Monashtiri,
E se gacat n'tökë Shqyptarvet
Rrijn tu' i shti hiri e pa hiri.

Medjë, thonë një fjalë më tepër,
Knjaz Nikolla me shallvarë
Don me marrë Malsin e ëper
Me gjith Shkoder sâ ma parë
E shka t' lânë kta kater ujq,
Qÿ i kerchohen shoqi-shojt
Thonë, do t' dalë një drej i kuq,
Qi pa dhimbë do t'i a njese thojt.
Edhe m' duket se per në,
Mor' Shqypfarë, ky djall i zi
Sa më para ka me lé,
Pse na drëqiiit kem' kojshi..,
Por kô fjalë ktu s' hijn n' kuvend
Ë po i lâ më per një hêrê tjeter
Veç po u thom tash rënd e rënd
Shka kam kndue nder libra t' vjetra,
Moren pè'n e n' Arte u ulen,
Kû Shqypnija e ka kufi'n.,
Aty 'i kûj në dhé e ngulen
E me matë xün rrokullin,
Kaluen zaje e kaluen dete
Tue matë token me njatë pè;
Pane fise e pán qytete
Qi jetojshin per nen ré.
Pán si gjyqin njeri e dán,
Kúr per s'teprit të lakmojë,
Edhè ndien si i drejti kján,
N' kthetra t' t'fortit kur t' takojë.

Pán si n' shekull mund t' jetohet
Me tamah e pa dashtni,
E sá gjaku edhe dikohet
E sa lodja pa dobi.
Pán si t' vorfnin, t' ngathun boret,
E qèstisê n' derë t' vet bujari,
E si t' lan'nit krejt mbas doret
Mund t'i shndrise parzmja n' ari.
K'shtû tu' èndün n' anë prej Lejet,
E tue u matê token me pê,
Ata ü kap'en m'atê shkamb Pejet,
Kû vonë bora vjen tue dé.
Por aty nji punë u bini
(E shka s'bijn n'ketê shekull t'zi?)
Pêni i mndashit nuk u mbrini,
Per me mate ketë Shqyptari,
Veç se ata i a bâne hallin
E nuk ndêjen kot tu u talle?
Pse me t' shpeitë e thirren djallin,
Edhe e ropen per së të gjalli.
E, mbasi i a hoqne lkuren
Ata tjeter mâ nuk ngjaten,
Por me té nji dredhë e tu'ren
Ë me atë dredhë Shqypnin e maten.
E q' m' atë ditë, qi dheu i Shqyptarit,
Me atë rodë dredhet pat kënë matë,
Duen me thânê, se 'i púnë per s'mbarit
Aty mâ s' mundet me ngjatë,

*

Qe, pra, tash se per ç'arrsye
Punë n' Shqypni s' jet pa u shperthye,
Due me thânë, pa u partallisun
Çdo pünë mbarë qi t' jete nisun.
E kjo nâmë, ase kjo rrfë,
Ka me ngjatun, thom, nder né
Dersá menden na t' a rrisim
E me dije mos t' a shndrisim;
Dredha e djallit, pse s' âsht tjeter,
Si e kam kndue nder libra t' vjeter,
Veç padija edhe krenija,
Qi shkojn njitë si trupi e hija.

Disa sentenca të thëna prej tij:

**Nga një ndër mendjet më të ndritura të trojeve
tona. At Gjergj Fishta**

*-Ma kollaj asht me mbushun një thes me pleshta sesa
me i ba bashk dy shqyptarë! (kjo vlen edhe për këtë
debat që po bëhet për figurën e Tij)*

*– Njerëzit janë tanë njisoj prej natyrës, edukata i ban
me u dallue!*

*– Shqiptarët kallzojnë njate çka s'duhet, e mshehin
njatë çka e di tanë bota! (edhe kjo vlen për debatin)*

– Pak din njaj që ia kallzon të tana grues!

*– Në kjoftë se provon, mundesh me hupë, por në
kjoftë se nuk provon – je i hupun gjithsesi!*

- *Në kjoftë se thue at çka dishron, duhet me ndie edhe ate çka nuk e dishron!*
- *Ma mirë n'vorr me u kja për mall/ se nën shkja me ndejë për t'gjallë,,*
- *Vërtetë kemi Bajram e Pashkë, por Shqiptarinë e kemi bashkë!*
- *N'daç me gzue t'bukrën liri/ mos shkel fis, as mik, as fe/ pse n'kto sheja bota mbarë./ na dallon se jem shqiptarë...*
- *Edhe atij iu thaftë po goja/ që përbuzë këtë g'juhë hyjnore/ qi n'g'juhë t'huej, kur s'asht nevoja/ flet e t'veten e lèn mbas dore...*
- *Mbi njatë flamur Perendija/ me dorë t'vet Ai e ka shkrue/ "Për Shqiptarë do t'jët Shqypnija/ kush u a prekë, ai kjoftë mallkue"...*
- *Po, edhè hâna do t' a dijë/ edhè Dielli do t' két pá/ se për qark ksaj rrokullije/ si Shqypnija 'i vend nuk ká...*
- *Në rast se ata nuk na duan në një shtet të vetëm, pasi thonë shqiptarët qenkan muslimanë, aherë... na kristianët do t'i shkriejmë kryqet tona dhe do t'i bajmë fishek me mbrojt vllaznitë tanë muslimanë shqiptarë!*
- *Më dhemb kryet me njato parla-parla të parlamentarëve: dokrra pa kokrra!*
- *Veç padija edhe krenija,/ Qi shkojn njitë si trupi e hija.*

Në këto sentenca që paraqita më sipër, bie në sy, krahas elementeve që citova për poezitë e tij, edhe përdorimi i grupit të bashkëtingëlloreve **kj** që mirditorët e kanë ose **q**, ose **ç**: *me u kja* - me u qa; *Në kjoftë se*-Në qoftë se; Qoftë përmes këtyre sentencave që sollëm aty më sipër, qoftë edhe tek poezitë e tij që i paraqitëm para këtyre sentencave, po edhe në të gjitha shkrimet e tij nuk gjen qoftë edhe një nuancë mirditore. Në asnjë vend nuk e gjen përdorimin e **q** për **ç** dhe as **n** për **nd**. Kështu edhe rastet e shumta të përdorimit të **y** në disa fjalë çka për mirditorët e kohës së Tij nuk ishte aspak e normës, për mos me thënë, e pamundur të shqiptohet drejt e saktë, tregojnë për një qenie e Tij në grupin etnik zadrivor e jo mirditor. Po ta analizojmë gjuhën e përdorur në ato shkrime, mund të sillnim edhe shumë e shumë argumente të tjera, por besoj se mjaftojnë këto dy-tre elemente që solla si shembull.

Thënie për At Gjergj Fishtën:

“Me Fishtën nxente fill zhvillimi i gjuhës së shkrueme shqipe tue u nisë drejtpërdrejt nga bazat e të folmes popullore. Përvoja dhe trashëgimi i Fishtës po në këtë drejtim asht gur themeluer i gjuhës letrare shqipe, pa përjashtim rrymash, tue përfshi edhe ata shkrimtarë njoftsa dhe studiuesa të letërsisë moderne perendimore”.

[**Martin Camaj**]

"At Gjergj Fishta, jo vetëm se është poet kombëtar, madje poet i popullit, njëlloj "Sommo poeta shqiptar", por ai është figurë e këtillë në shumë fusha të letërsisë dhe të kulturës. Dhe vetëm duke e njohur në tërësinë e tij, të pafragmentuar, të pacunguar, ai bëhet i kuptueshëm, i dobishëm dhe referencë e përhershme e identitetit tonë shpirtëror, kulturor dhe kombëtar".
[Fatmir Koliqi]

Atë, sa gjana do bahen nesor ne emnin tan, sa shume gjana do thuhet, sa shume do lihen pa thane! Sa shume njerez do shtiren, e sa pak njerez do të jena Aty per Ty...Po Ti s'e ki problem! Asnjehere s'u ankove; as kur t'i hodhen eshtnat n'Dri, as kur t'lane pa vorr, as kur ta zhduken vepren tane-kryeveper tonen, as kur dishepuj te Tutë shkonin ne gijotine, ma e mira ne burg, internim e ma e randa, ajo qe ska ndodh kerkund tjeter brenda nje populli- me u ekzekutu n'Zall t'Kirit! Atë, nesor do thuhet gjana te mira per Ty! Do rreken pak njerez te tregojne se s'ja kane dhane krejt shpirtin shejtanit, ndersa te tjere, duhet, Atë, do t'jane te paguem si nderit e tyne prej 70 vjtresh kunder Teje! Po ti je vigan: s'pyet per cikrrima! S'ki pyet kurre! Prape "I Dbuemi" i terbon! I shkaterron! E dine se asnje i madh s'mundet me e shkruet ma! Ndoshta nesor diku, neper Shqipni, dikush ka me e knue ktë kangë, e ka me iu gzue si dikur kur msheftas percillej nder besimtarë si

Psalmet!

Nga Qielli Ti kundron i qete e i pezmatuem njeheresh se kerkush mbi kete Toke, per ma shume se 1 shekull, nuk e lartsoi Shqipnine si e sa Ti!

Na mungon vertet, ndonese falë Zotin je kudo me ata qe te dun si e sa Lahutën...

Nga **Nikoleta Kovaçi**.

EMNIMI I AT GJERGJ FISHTES ANTAR I AKADEMISË ITALIANE.

“...Fatkeqsisht, disa prej atyne që hiqen si supernacionalistë, pozitë të cilen fituan tue ndejtë strukun mbas një patriotizmi fals, e qortojnë poetin për faktin se me 1939 pat pranue me u emnue Akademik i Italisë. Akuzojnë mendjemadhsisht për mungesë patriotizmi mjeshtrin, i cili harxhoi tanë jetën e vet për t’u mesue shqiptarve se si me e dasht atdheun. Dhe akuza, jo veç në Shqipninë e sotme, por mjerisht edhe në ndonji pjesë të Diasporës, ka gjetën një lloj kodifikimi. Dhe nuk synohet me u denigrue thjeshtë njeriu dhe politika e tij aqsa komuniteti prej të cilit ai rrjedhë, besnikëria ndaj traditave që i japin tharm veprës, e qytetnimi perëndimor që na ushqen me shpirtin e madh. Tue i akordue interpretuesit të shpirtit shqiptar titullin akademik, Italia dishronte me nderue Shqipninë. Qeshë i pranishem në Romë në qeshorin e vitit 1933 kur u muer vendimi në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Më kishin thirrë për tu këshillue rreth

çështjes në fjalë. Morën pjesë në këtë mbledhje, veç tjerve, Zenone Benini nënsekretar për çështjen shqiptare. Ambasadorët Jakomoni i San Savinios e Karlo Straneo.

U kërkoi ndjesë ndijuesve të nderuem nëse jam i detyruem me përmend ndërhyrjen që bana me këtë rast. Ndjej si detyrë me e zbulue këtë të vërtetë, për me e davaritë hijen me të cilen përpiqen me errsue kujtimin e Poetit, të cilin e pata udhërrëfytes dhe mbështetje në rrugën time letrare.

Benini, që drejtonte mbledhjen, njoftoi se qeveria Italiane, për t'i nderue në mënyrë konkrete vlerat kulturore të kombit shqiptar, propozonte tre shkrimtarë si antarë të Akademisë së Italisë. Emnat që u përmenden ishin: Patër Gjergj Fishta, Torenc Toçi, Ernest Koliqi. Benini e dalloj menjëherë se fytyra që kontraktue. Kishte shpresue se me e pa tue shkëlqye nga krenaria, sepse me pyeti “ Nuk e miraton këtë ide?” U ndieva i detyruem me folë me sinqeritetin ma të thellë. U përgjigja se ideja më dukej shumë e mirë e që një nderim kaq i naltë për vlerat e kulturës shqiptare do t'i kënaqte e do ti mbushte me krenari tanë shqiptarët, por shtova se Koliqi duhej konsiderue si një autor, cikli letrar i të cilit vijonte me qenë në zhvillim, kësisoj ende nuk ka mbërrit në atë pikë që i jep kunorzimin e përhershëm një shkrimtari. Sa për Toçin, nuk mund të mohoj se asht një kolitivues i vyeshëm i studimeve juridike e një gazetar i stervitun, por nuk ka

botue asnjë vepër letrare a shkencore të tillë, sa me meritue dinjitetin e Akademikut. E mbylla me fjalët se në të tre këta emna, Fishta asht i vetmin personalitet i pakundërshtueshëm, i denjë për tu pranue në bashkësinë e naltë kulturore italiane, me që ai dhe vetëm ai, përmblihte në vete dhuntinë ma të shkqlyeme të krijimtarisë artistike të rracës. Benini, tue drejtue kah të pranishmit, vlerësoi konceptin e naltë, që unë kisha për Akademinë e Italisë. Mandej deshti me dijtë nëse ekzistonte në Shqipni ndonji tjetër shkrimtar që meritonte me ndejtë përkrah Fishtës. U përgjigja, simbas pikëshikimit tim modest, se ekzistonin dy shkrimtarë shqiptarë që s’do të kishin ba figurë të keqe në gjinin e Akademisë: zz. Fan Noli e Faik Konitza, por shtova se banonin prej shumë kohësh në Amerikë. Kështu Fishta ishte i vetmi që u emnue akademik i Italisë. Emnimi, tue qenë se nuk ishte paralajmerue gjeti në befasi. Fundja tue njoftë natyrën e tij krenare, qeshë i sigurtë se do ta kishte refuzue me përçmim vlersimin e naltë, nëse do t’ishin përfshi edhe dy shqiptarë të tjerë me merita letrare ma të pakta. Sigurisht se do ta kishte refuzue, e jo për mendjemadhsi, por sepse tue pranue krahas tij dy të tjerë mjaft ma të pakët se ai për nga formimi letrar, emnimi do t’ishite zveshë nga vlera e vërtetë e do të kishte marrë kuptim tjetër. Kur mbas ceremonisë, e pashë në gjinin e Akadmisë së Italisë, më shprehu tanë entuziazëm fjalët që i kishte thanë Papa Piu XII:

“ Jam i kënaqun për emnimin tand akademik, sepse nëpërmjet tij nderohet Urdhni i Shën Françeskut e kombi shqiptar” Mandej poeti e la këtë temë dhe nisi të më shprehë brengat e tij për situatën evropiane. Ishim në fillimin e 1940.

Nji fat i kobshëm po na ndjek!” – thirri renkueshëm, a thue se po fliste me vete – “ E druej fort për të ardhmen e Shqipnisë....”

Ernest Koliqi

Marrë nga nji koment i Xhenc Bezhit.

Këtu mund të sillnim edhe plot shkrime të tjera, qoftë ato që flasin e vlerësojnë figurën e tij, qoftë jeshkrime, por mendoj se nuk ka vend për ato. E rëndësishme për figurën e tij është të krijojmë koncepte sa më të qarta, duke hedhur dritë mbi etnogjenezën e tij.

Para disa ditësh u kremtua 151-vjetori i lindjes së tij duke shtruar edhe drekën pak metra larg vendlindjes së poetit, tek pika turistike “Oazi”, duke bërë vizita tek vendi i lindjes, atje ku është ngritur një memorial, si dhe tek shtëpia muze, duke bërë edhe foto të ndryshme e vidio e duke i publikuar në rrjete sociale të ndryshme, duke recituar vargje nga veprat e Tij e duke organizuar edhe koncerte artistike me këngë të ndryshme. Mendoj, gjë fort e mirë dhe me shumë vend dhe nuk ka asnjë gjë të keqe se këtë manifestim vijmë dhe e organizojmë pikërisht ata që po e trumbetojnë me të madhe se gjoja At Gjergj Fishta është mirditor nga Domgjoni, edhe pse për koinçidencë paskësh lindur në Fishtë. Nuk

pashë asnjë foto nga dhjetëra e qindra të publikuara, të jenë bërë në Domgjon, atje ku ngulin këmbë se Ai e ka origjinën dhe etninë. Kjo ndoshta se nuk do mundeshin t'i merrnin me hir e me pahir ata njerëz e t'i çonin atje, ose ndoshta atje pak vetë janë dhe e dinë se At Gjergj Fishta ishte prej andej.

Por ka edhe një gjë tjetër. Në të gjitha ato foto që pashë një për një, askund nuk më zuri syri ndonjërin prej të njohurve të mi që i përkasin gjakut më të afërt të At Gjergj Fishtës. Nuk them se nuk kishte, pasi aty pashë plot prej atyre që i përkasin gjakut më të afërt, siç ishte P.Nd., por nuk pashë S.Nd., T.Nd., Gj.Nd., as ndonjë tjetër që unë i njoh mirë dhe për mua janë figura mjaft të spikatura që ai fis ka. Ndoshta dy të parët nuk mund të merrnin pjesë aty, se ishin larg dhe kjo është plotësisht e justifikueshme, por kolegu im i nderuar, profesori Gj.Nd., nuk e kuptoj se mund të kishte ndonjë arsye ta pengonte, kur vinin nga Domgjoni, apo Kosova të tjerë për të kremtuar atje. Nuk dua të bëj aludime për arsyet, por e dyshoj se, ose kanë shprehur ndonjë mospëlqim të tyre për zhurmajnën e pavend që po bëhet dhe nuk janë të njëmendje me ata që me forcë e me këmbëngulje po duan t'ia ndërrojnë etninë (sa për origjinën, nuk besoj se e kundërshtojnë), ose mund të kenë pasur arsye të tjera personale dhe nuk dua të abuzoj, por këtu më poshtë po paraqes disa nga shumë fotot e publikuara dhe po japim konkluzione rreth tyre:



Pasardhës të familjes së Gjergj Fishtës



Pasardhës të familjes së Gjergj Fishtës duke drekuar.



Pasardhës të familjes së Gjergj Fishtës dhe mysafirë mirditorë.



Pasardhës (gra zadrimore) të familjes së Gjergj Fishtës.



Pasardhës të familjes së Lekë Ndokës.

Nga të gjithë ato foto që paraqita më sipër, asnjëra prej grave pjesëmarrëse në atë ceremoni përkujtimore nuk kishte shenjë më të vogël të paraqitjes së etnisë së tyre mirditore, por ishin të veshura, ose me rroba qytetare siç visheshin në jetën e tyre të përditshme, ose veç me kostume tradicionale zadrimore dhe ky është një fakt mjaft domethënës dhe argument mjaft bindës se etnia e tyre ishte dhe është zadrimore e jo mirditore. Kushdo që e sheh ndryshe dhe kapet pas argumentave të ndryshme qoftë edhe të stisura, apo qofshin të vjela nga shkrime të ndryshme, apo hamendsimeve, ato foto të bëra dhe të publikuara aty nga vetë ata, flasin më shumë se çdo gjë tjetër dhe nuk duhet të kapen pas asaj që i thonë “gjurmë”, kur “ujkun” e kanë aty para syve.

Po, pashë edhe mirditorë, por veç burra të ardhur aty me misione të ndryshme, dhe ndoshta kjo ishte edhe arsyeja, pse ndonjëri prej miqve të mi të përmendur aty më sipër nuk kishin marrë pjesë, se nuk kishin dëshirë të merrnin pjesë në një gallatë të stisur duke luajtur me dinjitetin e tyre, se ata nuk e pranojnë faktin e të qenit me etni mirditore, kur të gjitha traditat e zakonet, si dhe nuancat gjuhësore i kishin të lindura që në djep dhe nuk i mësuari rrugës. Ndoshta edhe nga fakti se nuk e pranojnë dikënd të bëhet zot në shtëpinë e tyre e të komandojë e derigjojë sipas dëshirës së tij.

E kam cilësuar se edhe fisi im zbriti në Zadrinë nga malet e Mirditës, por, edhe pse nuk jam alergjik për atë popull që ka jetuar dhe jeton atje, nuk e pranoj që të më quaj dikush mirditor, pse nuk jam. Me zakone, gjuhë e tradita jam zadrinor dhe kisha babë e babëgjyshe veç me veshje zadrimore. Po kështu edhe nënë (edhe pse kjo kishte etni kallmetore), gjyshe dhe katragjyshe e stërgjyshe, ishin të gjitha me tradita dhe të veshura me veshje zadrimore dhe asnjëra prej tyre me veshje të etnive e krahinave të tjera. Gjithashtu, të gjithë këta e flisnin gjuhën e Zadrinës dhe zbatonin pikë për pikë të gjitha zakonet e traditat zadrimore. Besoj se këtë që sapo e deklarova për veten time, do ta deklaronte edhe At Gjergj Fishta po të ishte ende gjallë. Përsa i përket origjinës nuk e mohoj, por kjo nuk më bën të jem andej nga unë kam origjinën e largët. Besoj se këtë mendim ndajnë edhe pasardhësit e Lekë Ndokës, vëllait të At

Gjergj Fishtës, megjithëse, duhen pyetur ata vetë për ta vërtetuar këtë që sapo thashë. Po që e kundërta, po që se thonë se janë mirditorë, më duhet që unë të mbyll sytë për ato veshje të atyre katër grave që fotot i kanë paraqitur me veshje zadrimore dhe jo mirditore.

Përmbajtja

HYRJE PËRSHKRUESE.....	1
LËVIZJET DEMOGRAFIKE.....	16
KUSHTET NATYRORE DHE EKONOMIKE.....	29
KUSHTET E REJA POLITIKE E SHOQËRORE.....	32
KATEGORITË ETNIKE TË ZADRIMËS.....	46
Komenti im tek intervista e Llesh Dodës:.....	121
G'JUHA SHQYPE.....	131
DREDHA E DJALLIT (1908).....	133
Disa sentenca nga At Gjergj Fishta.....	139
Thënie për At Gjergj Fishtën.....	141
EMNIMI I AT GJERGJ FISHTES ANTAR I AKADEMISË ITALIANE.....	143
Konkluzione.....	146